



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria -Vlada-Government*

# **PROGRAMI I QEVERTISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2021 - 2025**

**Maj 2021**

## Përbajtja

<b>QËLLIMET E PROGRAMIT TË QEVERISË .....</b>	5
<b>1. Prioritetet e Qeverisjes .....</b>	6
<b>1.1 Menaxhimi i pandemisë së Covid-19 .....</b>	6
<b>1.2. Ringjallja ekonomike .....</b>	8
<b>2. Plani i Qeverisë .....</b>	10
<b>2.1. Shëndeti publik dhe mbrojtja sociale .....</b>	10
<b>2.1.1 Reformimi i sektorit të shëndetësisë .....</b>	10
<b>2.1.2 Mbrotjtja sociale .....</b>	11
<b>2.2. Sundimi i ligjit .....</b>	12
<b>2.2.1 Përmirësimi i integritetit të institucioneve të drejtësisë .....</b>	12
<b>2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative .....</b>	12
<b>2.2.3 Adresimi i gjenocidit dhe krimeve të kryera gjatë luftës dhe vlerave të mbrojtura me të drejtë ndërkombëtare .....</b>	14
<b>2.2.4 Përmirësimi i shërbimeve të profesioneve të lira ligjore dhe digitalizimi i sistemit të drejtësisë .....</b>	14
<b>2.2.5 Parandalimi dhe adresimi i dhunës në familje, ndaj grave dhe në baza gjinore .....</b>	15
<b>2.3. Rendi dhe siguria publike .....</b>	16
<b>2.3.1 Parandalimi dhe luftimi i krimit .....</b>	16
<b>2.3.2 Rritja dhe ruajtja e sigurisë publike .....</b>	16
<b>2.3.3 Forcimi i integritetit të institucioneve të rendit dhe sigurisë .....</b>	16
<b>2.4. Qeverisja .....</b>	17
<b>Modernizimi i administratës publike .....</b>	20
<b>2.4.5 Digitalizimi për shërbime më të mira .....</b>	21
<b>2.5. Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore .....</b>	24
<b>2.6. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve .....</b>	24
<b>2.7. Rritje gjithëpërfshirëse ekonomike .....</b>	26
<b>2.7.1 Sigurimi i qëndrueshmërisë së financave publike .....</b>	26
<b>2.7.2 Rimëkëmbja Ekonomike - krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik .....</b>	26
<b>2.7.3 Ridisejnimi i politikave fiskale .....</b>	26
<b>2.7.4 Formalizimi i ekonomisë .....</b>	27
<b>2.8. Industria, ndërmarrësia dhe tregtia .....</b>	28
<b>2.8.1 Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes .....</b>	28
<b>2.8.2. Zhvillimi i qëndrueshëm nëpërmjet turizmit .....</b>	28
<b>2.8.3. Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe inovacionit .....</b>	29
<b>2.8.4. Promovimi dhe përkrahja e investimeve .....</b>	29

<b>2.8.5. Zhvillimi i politikave industriale dhe tregtare .....</b>	<b>30</b>
<b>2.8.6 Përmirësimi i infrastrukturës së cilësisë, përfshirë mbrojtja e konsumatorit.....</b>	<b>30</b>
<b>2.9. Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të TIK .....</b>	<b>32</b>
<b>2.10. Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural.....</b>	<b>33</b>
<b>2.10.1 Reformat gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për shërbime më efikase .....</b>	<b>33</b>
<b>2.10.2. Rritja e konkurrencës në sektorit agro-ushqimor.....</b>	<b>33</b>
<b>2.11. Zhvillimi rajonal .....</b>	<b>35</b>
<b>2.12. Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor .....</b>	<b>36</b>
<b>2.12.1 Përmirësimi i cilësisë së ajrit .....</b>	<b>36</b>
<b>2.12.2 Menaxhimi i integruar i mbeturinave.....</b>	<b>36</b>
<b>2.12.3 Menaxhimi i ujërave dhe ngritja e infrastrukturës .....</b>	<b>36</b>
<b>2.12.4 Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit .....</b>	<b>37</b>
<b>2.12.5 Planifikimi hapësinorë i qëndrueshëm .....</b>	<b>37</b>
<b>2.12.5 Banimi social dhe banimi i përballueshëm .....</b>	<b>37</b>
<b>2.13 Infrastruktura.....</b>	<b>39</b>
<b>2.13.1 Infrastrukturë rrugore të integruar .....</b>	<b>39</b>
<b>2.13.2 Infrastrukturë hekurudhore për zhvillim ekonomik.....</b>	<b>39</b>
<b>2.13.3 Politikat e avacionit civil .....</b>	<b>39</b>
<b>2.13.4 Siguria dhe mirëmbajtja rrugore .....</b>	<b>40</b>
<b>2.14 Energjia dhe minierat .....</b>	<b>41</b>
<b>2.14.1 Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji .....</b>	<b>41</b>
<b>2.14.2 Përmirësimi i performancës së sektorit minerar .....</b>	<b>41</b>
<b>2.15 Arsimi dhe shkenca .....</b>	<b>42</b>
<b>2.15.1 Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i digjitalizuar.....</b>	<b>42</b>
<b>2.15.2 Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës .....</b>	<b>43</b>
<b>2.15.3 Menaxhim efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet .....</b>	<b>43</b>
<b>2.15.4 Arsim i lartë me cilësi dhe integritetit, në harmoni me standardet ndërkombëtare .....</b>	<b>43</b>
<b>2.15.5 Përmirësimi i mjedisit për kërkime dhe inovacion .....</b>	<b>44</b>
<b>2.16 Kultura, Rinia dhe Sporti .....</b>	<b>45</b>
<b>2.16.1 Arti dhe kultura si kontribuues qenësor në mirëqenien shoqërore e ekonomike .....</b>	<b>45</b>
<b>2.16.2 Trashëgimia kulturore për promovim të vlerave dhe rritje ekonomike .....</b>	<b>46</b>
<b>2.16.3 Sporti zhvillues i imazhit shtetëror dhe mirëqenies shoqërore .....</b>	<b>48</b>
<b>2.16.4 Fuqizimi i të gjithë të rinjve në jetën ekonomike dhe sociale të vendit .....</b>	<b>50</b>

<b>2.17 Politika e jashtme dhe diaspora .....</b>	<b>52</b>
<b>2.17.1 Shtet ligjor demokratik me synim integrimin në BE dhe NATO .....</b>	<b>52</b>
<b>2.17.2 Thellimi i bashkëpunimit me vendet me interes strategjik dhe marrëdhënieve dypalëshe .....</b>	<b>52</b>
<b>2.17.3 Me pavarësi dhe profil të qartë në bashkëpunimin rajonal .....</b>	<b>53</b>
<b>2.17.4 Thellimi i bashkëpunimit me Shqipërinë .....</b>	<b>53</b>
<b>2.17.5 Rritja e rolit të mërgatës në zhvillimin dhe promovimin e vendit.....</b>	<b>53</b>
<b>2.17.6 Reformimi i shërbimit të jashtëm.....</b>	<b>54</b>
<b>2.17.7 Avancimi i diplomacisë ekonomike dhe diplomacisë publike .....</b>	<b>55</b>
<b>2.17.8 Liberalizimi i vizave .....</b>	<b>55</b>
<b>2.17.9 Raporti me Serbinë .....</b>	<b>55</b>
<b>2.18 Politikat e mbrojtjes .....</b>	<b>58</b>
<b>2.18.1 Zhvillimi i kapaciteteve për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial .....</b>	<b>58</b>
<b>2.18.2 Mbajtja e kapaciteteve ekzistuese për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile.....</b>	<b>58</b>
<b>2.18.3 Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile dhe rritja e llogaridhënieς dhe transparencës .....</b>	<b>58</b>
<b>2.18.4 Anëtarësimi në organizata, bashkëpunimi me vendet tjera dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare.....</b>	<b>58</b>
<b>3. Prioritizimi, dhe monitorimi i zbatimit të Programit të Qeverisë .....</b>	<b>60</b>
<b>Shtojca 1: Programi legjislativ për vitin 2021 .....</b>	<b>61</b>

## QËLLIMET E PROGRAMIT TË QEVERISË

Programi i Qeverisë është dokumenti themelor me të cilin Qeveria e komunikon vizionin e saj para qytetarëve të Republikës së Kosovës për qeverisjen e saj. Programi i Qeverisë e pasqyron qasjen dhe parimet që do të ndiqen përgjatë qeverisjes dhe priorititetet themelore e iniciativat që do të merren në të gjitha fushat për përmirësimin e gjendjes në vend.

Ne synojmë të fokusohemi në dy prioritete themelore dhe më urgjente. Prioriteti i parë është fokusimi në menaxhimin e pandemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 me synim të minimizimit së pasojave në shëndetin publik. Prioriteti i dytë është fokusi në lehtësimin e pasojave ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga pandemia, që kërkon mobilizimin e tërë potencialit shtetëror. Po ashtu, do të fokusohemi në luftimin e krimit e korruptionit dhe në transformimin ekonomik e social të vendit, me synimin e përfshirjes sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ky program i pasqyron orientimet e përgjithshme të qeverisjes sonë, sa i përket ajendës së integrimit evropian dhe politikës së jashtme. Ai transmeton frymën demokratike dhe pluraliste të vendit, që siguron kompletimin e procesit të shtet-bërjes dhe integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në kuadër të institacioneve rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Programi është i strukturuar në atë mënyrë që paraqet prioritetet e qeverisjes dhe planet sektoriale, të ndara në fusha të politikave dhe në sektorë të politikave publike. Për secilën Ministri janë identifikuar qëllimet strategjike, të cilat janë identifikuar gjatë hartimit të Planeve Strategjike dhe Operacionale të tyre. Në shtojcë është paraqitur tabela që paraqet strukturën e Programit me përgjegjësitë e ministrite dhe të Zyrës së Kryeministrat, për secilin qëllim strategjik dhe Programi Legjislativ për vitin 2021.

## **1. Prioritetet e Qeverisjes**

### **1.1 Menaxhimi i pandemisë së Covid-19**

Pandemia COVID-19 si sëmundje e nivelit global, përveç problemeve shëndetësore, ka shkaktuar dëme socio-ekonomike në Republikën e Kosovës. Bazuar në këtë, parandalimi kontrolli dhe menaxhimi i pandemisë në vendin tonë, mbetet prioriteti kryesor.

Me synim të menaxhimit të pandemisë, parandalimit të shpërndarjes së infeksionit, trajtimit të pacientëve dhe rehabilitimit të tyre, do të ndërmarrim hapat si në vijim:

- ⇒ Sigurimin e vaksinës për 60% të qytetarëve, në grup moshën e atyre që duhet vaksinuar deri në fundin e vitit 2021;
- ⇒ Imunizimi i qytetarëve sipas planit shtetëror të Vaksinimit anti-COVID-19, të cilin do ta rishikojmë në vazhdimësi ;
- ⇒ Hartimin e planit të ri për testim dhe gjurmim;
- ⇒ Rivlerësimin e efektshmërisë së masave të vëna dhe zbatimin të tyre, analizën e situatës epidemiologjike dhe vënien e masave adekuate e të bazuara në të dhëna për parandalim të përhapjes së infeksionit;
- ⇒ Ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse shtetërore për zbatim të masave të vëna nga Qeveria;
- ⇒ Edukimin e vazhdueshëm mjekësor, zhvillimin e vazhdueshëm profesional për punëtorët shëndetësorë si dhe edukimin e promovim për qytetarët rrëth përditësimit të masave anti-COVID-19;
- ⇒ Informimin dhe edukimin rrëth vaksinimit nëpërmjet fushatave;
- ⇒ Hartimin dhe zbatimin e udhërrëfyesit dhe protokolleve për trajtim të pacientëve me COVID-19, me qëllim të përkufizimit të qartë të detyrate dhe përgjegjësive të profesionistëve shëndetësorë në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, që ofron qartësi për qytetarët se në cilin nivel të kujdesit shëndetësor duhet të drejtohen për shërbime shëndetësore;
- ⇒ Kostimin dhe buxhetimin e udhërrëfyesit dhe protokolleve klinike, me qëllim të sigurimit të barnave dhe produkteve medicinale anti-COVID-19, me qëllim të parandalimit të varfërimit të qytetarëve, apo pagesave nga të ardhurat e tyre;
- ⇒ Ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve infrastrukturore, burimeve njerëzore, me qëllim të rritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për trajtimin e duhur të pacientëve me COVID-19;
- ⇒ Pako emergjente financiare për mbështetje të trajtimit klinik për të shtruarit në klinikat e dedikuara për trajtimin e pacientëve me COVID-19;
- ⇒ Ngritjen e kapaciteteve dhe mundësive për përcjelljen e pacientëve post-COVID-19, me theks të veçantë në shëndetin fizik dhe mendor të tyre;

- ⇒ Ndihmës direkte për familjet që kanë humbur kryefamiljarin ose burimin e financimit, si pasojë e humbjes së jetës nga Pandemia.

Të gjitha këto masa do të bazohen në të dhëna faktike e analiza të situatës epidemiologjike. Kjo qasje do të vazhdojë si detyrim për të marrë për bazë të dhënrat shkencore në raport me pandeminë.

Si masë me prioritet më të lartë është angazhimi për sigurimin e vaksinave. Në këtë aspekt, duhet të theksohet që nëpërmjet burimeve të ndryshme gjatë vitit 2021, synojmë vaksinimin e 60% të qytetarëve të Kosovës. Sigurimi i kësaj mase do të bëhet në dy drejtime: nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe zotimet e tyre në kuadër të Aleancës Covax, si dhe nëpërmjet angazhimit të Ministrisë së Shëndetësisë, si udhëheqëse e negociatave në nivel të Qeverisë, për sigurimin dhe shpërndarjen e vaksinave. Do të sigurohemi që, në vazhdimësi, të ketë vaksinim të popullatës përkitazi me Planin Nacional të Vaksinimit.

Prioriteti tjeter kryesor i yni është parandalimi dhe kontrolli i pandemisë në vend, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet masave adekuate për frenimin e përhapjes dhe parandalimit të infekzionit, të cilat parandalojnë rrezikimin e shëndetit publik dhe mbipopullimin e klinikave. Paralelisht me vendosjen e masave, do të fuqizojmë mekanizmat mbikëqyrës për monitorimin dhe zbatimin e masave dhe do të rrisim kapacitetet testuese dhe gjurmuese të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Po ashtu, do të rrisim dhe fuqizojmë kapacitetet klinike për trajtim, sipas protokolleve klinike të të shtruarve në klinikat e dedikuara për trajtimin e pacientëve me COVID-19.

Do ta parandalojmë rrezikun e madh të kontaktit me virusin i profesionistëve shëndetësorë, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, nëpërmjet vaksinimit, sipas planit shtetëror të vaksinimit. Në vazhdim të ngritjes së kapaciteteve spitalore, do të sigurojmë pajisje personale mbrojtëse, do të ngrisim kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore, si dhe do të standardizojmë trajtimin e pacientëve të shtruar nëpër klinikat e dedikuara për COVID-19, duke hartuar dhe rishikuar protokolle sipas standardeve dhe përvojave të mira të vendeve tjera.

Me qëllim të parandalimit të shpërndarjes së infekzionit, do të ndërmarrim fushata vetëdijësuese për qytetarët për mbrojtje nga infekzioni. Do të komunikojmë në vazhdimësi me qytetarët me transparencë dhe llogaridhënie rigorozë. Ministria e Shëndetësisë do të zhvillojë vazhdimisht strategji komunikuese për informimin sa më efektiv dhe konkret me qytetarët, e cila do të përkthehet në fushatë, jo vetëm për pandeminë COVID-19. Kjo fushatë, do të shfrytëzojë të gjitha burimet e informimit, për të qenë në tërësi e bazuar në fakte shkencore. Po ashtu, fushata do të ofrojë informimin e duhur, në funksion edhe të parandalimit të lajmeve të rreme rrëth pandemisë, duke i kushtuar kujdes të veçantë shëndetit mendor.

Për financimin e qëndrueshëm të sektorit të shëndetësisë, do të ndërmarrim masa konkrete për koordinimin e asistencës teknike dhe donacioneve, si pjesë përbërëse e rishikimit dhe konsolidimit të buxhetit të Kosovës.

## 1.2. Ringjallja ekonomike

Rritjen e fuqisë blerëse synojmë ta arrijmë nëpërmjet intervenimeve me masa për rritjen e likuiditetit tek amvisëritë dhe me mbështetjen e atyre që kanë nevojë më së shumti për ndihmën shtetërore. Nëpërmjet rritjes së pagës minimale në 250 euro, për 40 orë pune në javë, si dhe ngritjes së pragut të pagës që nuk tatohet në nivelin e pagës minimale, do të sigurohemi që ata që kanë paga më të ulëta, të kenë më shumë para në fund të muajit.

Daljen nga pandemia e shohim si mundësi të re për të ri-orientuar ekonominë drejt prodhimit e eksportit, drejt rritjes së punësimit të dinjitetshëm për të gjithë, si dhe drejt një zhvillimi të qëndrueshëm, që mbron ambientin edhe për gjeneratat e ardhshme.

Në këtë drejtim, do të angazhohemi për nxitje të investimeve në kapacitete të reja prodhuese e eksportuese, që krijojnë vende pune të qëndrueshme, nëpërmjet mbështetjes direkte të kreditimit për bizneset prodhuese.

Me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe cilësisë së prodhimit vendor, do të ofrojmë mbështetje për bizneset që investojnë në ngritjen dhe standardizimin e cilësisë, si dhe do të mbështesim aftësimin e punëtorëve dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

Pandemia ka rënduar gjendjen e shumë bizneseve. Ata ishin të detyruar të lirojnë nga puna një pjesë të stafit të tyre. Sidoqoftë, me rikthimin e aktivitetit ekonomik, do të kthehet edhe nevoja për ata punëtorë. Prandaj, do të mbështesim rikthimin në punë të atyre, që gjatë pandemisë, e humbën vendin e punës. Me masa të intervenimit, do të mbështesim edhe ata kanë qenë të papunë, e që kanë gjetur një vend pune. Ndërsa mbështetja më e madhe do të jetë për të rinxjtë, të cilët hyjnë në tregun e punës për herë të parë. Nëpërmjet skemës për punësim të garantuar për të rinxjtë, do të paguajmë pagën minimale për 1 vit, për secilin të ri që punësohet për herë të parë.

Për të siguruar financimin e planit për zhvillim ekonomik, do të negociojmë dhe nënshkruajmë marrëveshje ndërkombëtare financiare dhe do të emetojmë letra me vlerë.

Pjesë integrale e fuqishme e planit tonë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, janë mërgata jonë. Nëpërmjet krijimit të instrumenteve për investim, do të sigurohemi që kapitali i mërgatës sonë të kanalizohet në investime që krijojnë vende pune. Prandaj, duke filluar nga viti i parë, do të emetohen bono thesari të dedikuara për mërgatën.

Për të mbështetur fuqizimin ekonomik të grave dhe rritjen e punësimit, me fokus në të bërit biznes, do të zbatojmë masa aktive për punësimin e grave dhe masa mbështetëse për sigurimin e likuiditetit për bizneset që udhëhiqen nga gratë.

Për zhvillim ekonomik afatgjatë, deri në fund të vitit 2021, do të miratojmë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, e cila do të përfshijë adresimin e sfidave në të gjithë sektorët e politikave publike. Si një dokument gjithëpërfshirës, SKZH do të mundësojë ndërlidhjen me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, Marrëveshjen e Gjelbër dhe agjendën e integrimit evropian. SKZH do të shërbejë si mjet kryesor për zbatimin e prioriteteve të vendit, nëpërmjet përcaktimit të përparësive të zhvillimit, objektivave strategjike dhe rezultateve që duhen arritur. Gjithashtu, do të ndërmerren reforma strukturore për përmirësimin e mjedisin të të bërit biznes, investimeve në infrastrukturë dhe ndërlidhjen e shkathtësive me tregun e punës. Ringjallja ekonomike është një mundësi që të fokusohemi drejt ekonomisë së gjelbër dhe miqësore ndaj mjedisit.

Do të angazhohemi për krijimin e Fondit Sovran. Fondi Sovran do t'i marrë nën pronësi asetet strategjike të Republikës së Kosovës, për t'i valorizuar ato, për mundësimin e investimeve të jashtme dhe qasjen në tregje të huaja të kapitalit. Po ashtu, Fondi Sovran do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për investimet në rritjen e vlerës së Trepçës, KEK-ut, Telekomit dhe Postës. Si pasojë e kësaj, do të shuajmë Agjencinë Kosovare për Privatizim me anë të transferimit të saj në agjenci brenda Qeverisë.

Për arritjen e prioriteteve zhvillimore të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, do të krijojmë Agjencinë Zhvillimore, si një mekanizëm për udhëheqjen e politikave zhvillimore ndërmjet ministrive dhe agjencive të pavarura. Për më tepër, Agjencia do të mbështesë sektorin privat dhe publik në arritjen e synimeve strategjike zhvillimore, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të biznesit vendor, promovimit dhe rritjes së investimeve të jashtme dhe rritjes së eksportit.

Po ashtu, do të themelojmë Bankën Zhvillimore të Kosovës. Banka Zhvillimore do të jetë mekanizëm për mbështetjen e sektorit privat dhe promovimin e investimeve. Ajo do të jetë komponenti kreditues, që do të financohet nga paratë publike dhe shitja e letrave të borxhit, duke investuar në degë të caktuara të industriisë, që krijojnë vende pune dhe përmirësojnë bilancin tregtar.

## **2. Plani i Qeverisë**

### **2.1. Shëndeti publik dhe mbrojtja sociale**

#### **2.1.1 Reformimi i sektorit të shëndetësisë**

Vizioni jonë për shëndetësinë është popullata e shëndetshme. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta për të gjithë qytetarët e vendit. Prioriteti ynë për shëndetësinë, përveç menaxhimit të pandemisë COVID-19, është zbatimi i reformës gjithëpërfshirëse që mundëson zhvillimin e sistemit shëndetësor. Për këtë qëllim, do të hartojmë Strategjinë e re të Shëndetësisë.

#### **Riorganizimi i sektorit të shëndetësisë**

Do të rishikojmë kornizën ligjore të sektorit të shëndetësisë, me theks të veçantë ligjin për shëndetësinë, me qëllim të reformimit të nevojshëm dhe në hap me zhvillimet bashkëkohore. Me anë të reformimit të sektorit të shëndetësisë, do të funksionalizojmë kujdesin paliativ dhe do të fuqizojmë kapacitetet e inspektimit dhe monitorimit. Me vëmendje të veçantë do të trajtojmë funksionalizimin e sistemit unik dhe të integruar të informimit shëndetësor, që rregullon sistemin e referimit të pacientëve në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

#### **Cilësia e shërbimeve shëndetësore**

Do të angazhohemi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore. Do të kujdesemi për grupet e cenueshme të shoqërisë me fokus në rritjen e shkallës së vaksinimit të fëmijëve dhe avancimin e konceptit të mjekësisë familjare. Për rritjen e cilësisë dhe shërbimeve, do të bëjmë rrjetëzimin e mjekëve kosovarë në mërgatë dhe do të bëjmë ndërlidhjen me organizatat dhe odat e profesionistëve shëndetësorë, nëpërmjet programit të shkëmbimit të profesionistëve. Po ashtu, do të fuqizojmë kapacitetet për luftimin e sëmundjeve ngjitése, jongjítëse dhe sëmundjeve të rralla, si dhe do të rrisim bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

#### **Sigurime shëndetësore publike**

Një nga prioritetet më të rëndësishme në sistemin shëndetësor është ndryshimi i Ligjit për Sigurim Shëndetësor dhe fuqizimi i kapacitetave administrative njerëzore dhe infrastrukturore në Fondin për Sigurime Shëndetësore, si kushte për fillimin e grumbullimit të kontributeve. Këtë proces do ta zhvillojmë në të njëjtën kohë me kompletimin e Sistemit Informativ Shëndetësor dhe hartimin e udhërrëfyesve klinikë. Po ashtu, për këtë qëllim, do të kompletojmë legjislacionin dytësor për zbatimin e lirimit nga pagesa e premiumeve, bashkëpagesat dhe bashkëfinancimin për shërbime shëndetësore, skemën e barnave jashtë spitalore, kontraktim të barnatoreve dhe trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike.

## **2.1.2 Mbrojtja sociale**

Vizioni jonë është rritja e mirëqenies për të gjithë qytetarët, pa dallim. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet mbështetjes së grupeve të cenuara dhe ristrukturimit të skemave sociale dhe pensionale, me qëllim të uljes së varfërisë dhe rritjes së aktivitetit në tregun e punës.

### ***Ulja e varfërisë dhe rritja e mirëqenies sociale***

Rritjen e mirëqenies sociale dhe uljen e varfërisë do ta bëjmë nëpërmjet disejnimit të skemave të reja sociale dhe pensionale, ku përfshihen skemat për punësim të garantuar sezonal për nga një anëtar të familjes, për të gjithë ata që janë të përfshirë në këto skemat .

Për këtë qëllim, do të rimbursojmë të gjitha familjet që kanë të ardhura të ulëta, varësisht nga të ardhurat vjetore që marrin këto familje. Do të fillojmë zbatimin e programit të shtesave përfmijët. Fëmijët nën moshën 2 vjeçare do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 20 eurove në muaj, ndërsa fëmijët nën moshën 16 vjeçare, do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 10 euro në muaj. Do të ndryshojmë pushimin e lehonisë dhe atë prindëror, në atë mënyrë që të dy prindërit ta kenë këtë mundësi. Për nënët e papuna, do të paguajmë pagën minimale prej 250 euro, për 6 muajt e pushimit të lehonisë. Po ashtu, do të rishikojmë dhe ristrukturojmë skemat aktuale sociale dhe pensionale, nëpërmjet pastrimit të listave të përfituesve të tyre.

Ndër të tjera, do të rishikojmë kornizën ligjore për skemat sociale dhe pensionale, ku hyjnë shërbimet sociale dhe familjare, skemat pensionale të finançuara nga shteti, ndihmat sociale, vlerësimi, njohja e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuar. Do ta rishikojmë kornizën ligjore për financim publik të OJQ-ve dhe grantin për shërbime sociale dhe familjare. Me qëllim të evitimit të dyfishimeve në përfitime dhe keqpërdorimeve, do të ndërlidhim të gjitha bazat e të dhënavë për skemat e ndryshme sociale dhe pensionale.

### **Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve**

Prioritet i qeverisjes sonë është mbrojtja e të drejtave të punëtorëve dhe përmirësimi i kushteve në punë. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet rishikimit të kornizës ligjore për të drejtat e punëtorëve dhe sigurinë në punë. Për përmirësimin e kushteve në punë, do të fuqizojmë mekanizmat e zbatimit të ligjit. Do të rrisim inspektorët e punës, do të avancojmë kapacitetet Agjencisë së Punësimit, do të rrisim pagën minimale, do të njohim punën praktike si përvojë pune, do të ngrisim kapacitetet për shqyrtimin e ankesave nga punëtorët dhe do të rregullojmë pushimit e lehonisë dhe atij prindëror, siç u theksua më lartë.

## **2.2. Sundimi i ligjit**

Vizioni jonë është drejtësia e pavarur, e paanshme, efikase dhe profesionale. Këtë synojmë të arrijmë me anë të fuqizimit të sistemit të drejtësisë dhe rritjes së besimit qytetar.

Sundimi i ligjit është parimi themelor mbi të cilin do të punojë Qeveria, për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Për këtë qëllim, do ta luftojmë pa kompromis krimin e organizuar e korruptionin, terrorizmin, krimet ekonomike, dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe do të angazhohemi për respektimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare.

### **2.2.1 Përmirësimi i integritetit të institacioneve të drejtësisë**

Për përmirësimin e integritetit të institucioneve të drejtësisë dhe rritjen e besimit qytetar në drejtësi, do ta kompletojmë kornizën ligjore të nevojshme, për realizimin e procesit të vetingut. Për këtë qëllim, do të ndërmarrim hapa për fillimin dhe zhvillimin e procesit të vetingut në gjyqësor dhe prokurori, duke filluar nga nivelet e larta hierarkike. Vetingu do të jetë instrument kyç për verifikimin e integritetit, profesionalizmit dhe kontrollin e pasurisë të subjekteve të vetingut. Procesi i vetingut do të jetë i drejtë, gjithëpërfshirës, me konsultime të gjëra publike me ekspertë të fushës, shoqërinë civile, botën akademike dhe partnerët ndërkombëtar.

Ndër të tjera, sipas gjetjeve të Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, si nismë e Qeverisë së Kosovës e kryer në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë dhe akterët e tjerë kryesor të sektorit të drejtësisë, do të miratojmë Strategjinë për Sundimin e Ligjit, e cila ka për fokus çështjet e drejtësisë.

Po ashtu, me qëllim të rritjes së integritetit, do të reformojmë administratën e sistemit të drejtësisë, nëpërmjet politikave të reja dhe ndryshimit të nevojshëm të kornizës ligjore, si dhe do të riorganizojmë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe në atë mënyrë që të shërbejë për arritjen e vizionit dhe misionit të saj.

### **2.2.2 Reformimi i sistemit të drejtësisë penale, civile dhe administrative**

Do të angazhohemi në vazhdimësi për reformimin e drejtësisë penale, civile dhe administrative, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet ndryshimit të politikave dhe kornizës ligjore përkatëse.

Për avancimin e luftës kundër korruptionit, do të miratojmë Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, që përmban ndryshimet në organizimin dhe funksionimin e Agjencisë, si institucion i angazhuar kryesisht në parandalimin e korruptionit, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, trajtimin e rasteve të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publike, duke përfshirë edhe kontrollin si dhe prejardhjen e pasurisë dhe rastet e sinjalizimit. Po ashtu, do të ndërmarrim

veprime për vetëdijesimin e publikut për rëndësinë e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Do të finalizojmë hartimin e Kodit të Procedurës Penale, me të cilin do të parashihen dispozita ligjore që krijojnë qasje me të lehtë për luftimin e krimit të organizuar dhe korruptionit. Ndryshimet e reja të Kodit do të mundësojnë suspendimin nga puna të zyrtarëve publikë me rastin e ngritjes së aktakuzës për vepra penale. Po ashtu, do të parashohim mekanizma shtesë në mbrojte të lirive dhe të drejtave kushtetuese të personave të dyshuar.

Për avancimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korruptionit, do të hartojmë kornizën ligjore për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikueshme, që ka për qëllim konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustifikuar, nëpërmjet transferimit të barrës së provës te personi i dyshuar.

Po ashtu, do të ndërmarrim hapa për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe funksionale për garantimin e hetimit të plotë dhe profesional për rastet e krimit të organizuar dhe korruptionit. Për këtë qëllim, do të themelojmë mekanizmin e veçantë për luftimin e krimit të organizuar dhe korruptionit të nivelit të lartë.

Për reformimin e sistemit të drejtësisë civile, do të zhvillojmë reformën gjyqësore në fushën e drejtësisë komerciale, sipas rekomandimeve të dala nga Rishikimi Funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtojmë themelimit të Gjykatës Komerciale. Për funksionalizimin e Gjykatës Komerciale, do të rrisim numrin e gjyqtarëve të specializuar në fushën e drejtësisë komerciale. Përveç kësaj, do të promovojmë dhe fuqizojmë përdorimin e mënyrave alternative për zgjidhjen e kontesteve juridike.

Për reformimin e sistemit të drejtësisë administrative, do të kompletojmë kornizën ligjore për konfliktet administrative, me qëllim të ofrimit të qasjes më të lehtë në drejtësi, si dhe rritjes së efikasitetit të sistemit të drejtësisë administrative. Ndër të tjera, gjatë qeverisjes sonë, do të themelojmë Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Punës.

Për parandalimin dhe luftimin te krimit të organizuar dhe korruptionit ndërkufitar, do të krijohen mekanizma ligjor në mes Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera dhe institucioneve relevante ndërkombëtare, me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit ndërkombëtar. Për këtë qëllim, do të hartojmë Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale dhe Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Civile.

Po ashtu, do të hartojmë legjislacionin përkatës të nevojshëm për kompletim dhe ndryshim të politikave, ku përfshihen procedura penale, përgjegjësia disiplinore, prokurori i shtetit, evidenca penale, deklarimi i pasurisë, ekzekutimi i sanksioneve penale, shërbimi korrektues dhe sprovues, kodi civil, procedura kontestimore, të

drejtat pronësore, ndihma juridike falas, avokatia shtetërore, kontestet administrative, mjekësia ligjore. Ndër të tjera, në kuadër të reformës, do të kompletojmë kornizën ligjore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar dhe do të lidhim marrëveshje me vende tjera për bashkëpunim në çështjet penale, civile, transferim dhe ekstradim.

### **2.2.3 Adresimi i gjenocidit dhe kimeve të kryera gjatë luftës dhe vlerave të mbrojtura me të drejtë ndërkombëtare**

Për adresimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, do të rrisim kapacitetet profesionale të Prokurorisë Speciale, do të themelojmë Institutin për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë dhe do të hartojmë politikat për drejtësi tranzicionale dhe kornizën ligjore për personat e zhdukur.

Do të fuqizojmë kapacitetet profesionale të Prokurorisë Speciale, për adresimin e kimeve të luftës dhe shkeljeve të vlerave të mbrojtura me të drejtë ndërkombëtare dhe ofrimin e drejtësisë viktimate të këtyre kimeve. Do të themelojmë Institutin për krimet e kryera në Kosovë, me qëllim të gjetjes së fakteve për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, dokumentimit dhe arkivimit të tyre. Njëkohësisht, do të përgatisim padinë kundër Serbisë për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Po ashtu, do të angazhohemi në hartimin e politikave për drejtësi tranzicionale. Nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse, do të bëjmë identifikimin dhe promovimin e proceseve të ndryshme që do t'u garantojnë viktimate të kimeve të drejtë për drejtësi dhe për të vërtetën. Ndër të tjera, do të zhvillojmë një platformë reparative, e cila do të synojet përllogaritjen e dëmeve njerëzore dhe materiale të shkaktuara gjatë luftës.

### **2.2.4 Përmirësimi i shërbimeve të profesioneve të lira ligjore dhe digjitalizimi i sistemit të drejtësisë**

Me qëllim të krijimit të një mjeti më të përshtatshëm të të bërit biznes, si dhe ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, do të angazhohemi në fuqizimin e rolit të profesioneve të lira dhe rritjes së mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës së tyre. Po ashtu, do të angazhohemi për lehtësimin e qasjes në bazat e të dhënave shtetërore për noterët dhe përmbaruesit privat, me qëllim të rritjes së efikasitetit në punën e tyre. Do t'i përmirësojmë shërbimet e profesioneve të lira ligjore, nëpërmjet funksionalizimit dhe ristrukturimit të avokaturës shtetërore, kompletimit të kornizës ligjore për profesionet e lira dhe ngritjes e kapaciteteve për to.

Ndër të tjera, do të intensifikojmë përdorimin e teknologjisë moderne në sistemin e drejtësisë, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira dhe transparencës për publikun.

## **2.2.5 Parandalimi dhe adresimi i dhunës në familje, ndaj grave dhe në baza gjinore**

Dhuna në familje, ndaj grave dhe në baza gjinore është një nga problemet akute në vend, posaçërisht gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Për parandalimin dhe adresimin e kësaj dhune, do të hartojmë politikat kundër dhunës, do të funksionalizojmë mekanizmat kundër dhunës, si dhe do të organizojmë fushata vetëdijesuese për publikun për parandalimin e saj.

Për këtë qëllim, do të hartojmë politikat për parandalimin e fenomenit të dhunës në familje, koordinimin dhe bashkërendimin të veprimeve të të gjitha palëve pjesëmarrëse për mbrojtjen, trajtimin, rehabilitimin dhe integrimin e viktimate te dhunës ne familje, ndëshkimin dhe vënien përpara përgjegjësisë të kryesve të dhunës në familje, harmonizimin e legjislacionit vendor me atë ndërkombëtar, si dhe rishikimin e standardeve të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje. Po ashtu, do të përfshijmë Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kodin e ri Penal të Kosovës, gjë që do të ndikojë në numrin e rasteve të raportuara, ndjekjen penale të rasteve, si dhe lëshimin e sanksioneve adekuate nga gjykatat për rastet e dhunës. Për këtë qëllim, do të ngrisim kapacitetet e zyrtarëve përgjegjës në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Për evitimin e problemeve financiare të strehimoreve të cilat ofrojnë shërbime për strehim, do të ndërmarrim veprime konkrete, që linjën për Shërbime Bazike për Strehimoret, ta vendosim si linjë të përhershme në Ligjin për Buxhetin e Kosovës dhe do të ndryshojmë kornizën ligjore për ndihmë juridike falas, me qëllim të njohjes si kategori të veçantë për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Këto kategori, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë, do të mund të përfitojë ndihmë juridike falas në përfaqësim në gjykata si dhe në kontestet familjare dhe trashëgimore.

## **2.3. Rendi dhe siguria publike**

Vizioni jonë është garantimi e mjedisit të sigurt dhe ofrimi i shërbimeve cilësore, për të gjithë qytetarët, pa dallim. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet ngritjes së profesionalizmit, pavarësisë dhe llogaridhënisë, forcimit të integritetit institucional dhe rikthimit të besimit qytetar.

### **2.3.1 Parandalimi dhe luftimi i krimit**

Për parandalimin dhe luftimin e krimit, do të ngrisim kapacitetet njerëzore, analitike dhe hetuese të mekanizmave të rendit dhe sigurisë, do të kompletojmë dhe ndryshojmë kornizën strategjike dhe ligjore, si dhe do të rrisim ndërveprueshmërinë me institucionet tjera. Për këtë qëllim, do të racionalojmë kornizën strategjike, me qëllim të krijimit të një strategjie të konsoliduar shtetërore kundër krimit, e cila i përgjigjet rreziqeve reale dhe përmirëson koordinimin ndërinstitucional. Po ashtu, do të angazhohemi për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën ndaj krimit ndërkufitar dhe do të rrisim kapacitetet e kontrollit kufitar, duke zbatuar menaxhimin e integruar të kufirit.

### **2.3.2 Rritja dhe ruajtja e sigurisë publike**

Për rritjen dhe ruajtjen e sigurisë publike, do të zhvillojmë politikat në fushën e sigurisë dhe do të identifikojmë e kategorizojmë infrastrukturën kritike shtetërore. Meqenëse siguria kibernetike është një problem në zgjerim e sipër, do të angazhohemi në ngritje të kapaciteteve profesionale për parandalimin e sulmeve kibernetike, kompletimin e kornizës ligjore dhe modernizimin e pajisjeve për mbrojtje kibernetike. Po ashtu, do të modernizojmë shërbimet e regjistrimit civil, në funksion të shërbimeve më të mira për qytetarët dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndër të tjera, në bashkëpunim me komunat, do të forcojmë mekanizmat lokalë për siguri në bashkësi.

### **2.3.3 Forcimi i integritetit të institucioneve të rendit dhe sigurisë**

Për përmirësimin e integritetit në institucionet e rendit dhe sigurisë, do të zhvillojmë politikat dhe kornizën ligjore për veting. Për këtë qëllim, do të zhvillojmë politikat për inspektimin administrativ dhe do të përmirësojmë planet e integritetit për administratën publike. Për rritjen e besimit qytetar, do të forcojmë dhe ngrisim kapacitetet e Policisë, me theks të veçantë për hetimet e brendshme, Inspektoratit Policor dhe agjencive të tjera. Kjo do të përmirësojë menaxhimin e personelit dhe burimeve tjera në mënyrë efikase, eficiente dhe të ndershme. Po ashtu, do riorganizojmë Ministrinë e Punëve të Brendshme, në përputhje me kërkesat ligjore dhe atë mënyrë që të shërbejë për arritjen e qëllimeve të saj.

## **2.4. Qeverisja**

### **2.4.1. Planifikimi i integruar**

Do të zhvillojmë sistemin e integruar të planifikimit të politikave dhe të shfrytëzimit të burimeve financiare, duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë institucionale, forcimin e llogaridhënisë dhe rritjen e transparencës. Kjo do të bëhet duke vodosur tipet dhe hierarkinë e dokumenteve strategjike. Për fuqizimin e planifikimit, do të hartojmë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe do të vodosim përkufizimin e qartë të sektorëve të politikave, që ndërlidhen me planet dhe proceset e buxhetimit. Dokumentet planifikuese do të përmbajnë treguesit e performancës sektoriale, të ndërlidhura me vlerësimin e performancës individuale të nëpunësve publikë, që do të monitorohen dhe maten në mënyrë periodike, si pjesë e një sistemi transparent të llogaridhënisë së brendshme. Për avancimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit, do të krijojmë indeksin e treguesve vendorë të zhvillimit.

### **2.4.2 Agjenda e integrimit evropian**

Qeveria do të angazhohet për forcimin e avancimin e marrëdhënieve kontraktuale me BE-në nëpërmjet zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe reformave prioritare që sjellin vendin më afér BE-së dhe kontribuojnë në konsolidimin institucional dhe zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Agjenda e reformave evropiane do të fokusohet në forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjen e mirë, përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë dhe klimës së investimeve, si dhe forcimin e sistemit arsimor dhe punësimin. Në kuadër të kësaj agjende, do të punojmë për zvogëlimin e efekteve ekonomike dhe sociale të pandemisë COVID-19, në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me BE-në. Do të angazhohemi për të qenë pjesë e nismave rajonale, duke i zbatuar detyrimet e vendit, veçanërisht në kuadër të Procesit të Berlinit. Për mundësimin e planifikimit më të mirë të procesit të integrimit, gjatë qeverisjes sonë do të bëjmë:

- Vlerësimin e hollësishëm të zbatimit të gjertanishëm të MSA-së. Në përputhje me të gjeturat, do të ndërmarrim masat përkatëse që mundësojnë pëershpejtimin e zbatimit të saj;
- Planifikimin më të mirë të procesit të integrimit, me synimin e ndryshimit të kornizës ligjore dhe administrative nëpërmjet përbylljes së ciklit të reformave të pajtuara me BE-në, në kuadër të Agjendës së Reformave Evropiane (ERA 2);
- Koordinimin më të mirë të dikastereve shtetërore nëpërmjet intensifikimit të punës së strukturave koordinuese ndërinstitucionale për procesin e integrimit evropian; dhe

- Hartimin e kornizës së qartë institucionale për negociatat e anëtarësimit, e përbërë nga dy shtylla kryesore: strukturat për negociata, të organizuara në grupe pune sipas kapitujve të negociatave dhe një udhërrëfyes për adoptimin e legjislacionit (*acquis-së*) të BE-së në legjislacionin kombëtar, me synimin që brenda mandatit të parë të qeverisjes, Kosova të jetë e gatshme të marr statusin e shtetit kandidat.

Në kontekst të reformave më të rëndësishme në procesin e integrimit të vendit, vëmendje më e veçantë do t'i kushtohet:

- Përmirësimit të performancës së ndërmarrjeve publike, depolitizimit dhe heqjes së kontrollit politik mbi ndërmarrjet publike;
- Implementimin e MSA-së dhe standardet evropiane në sigurimin e konkurrencën e lirë dhe të drejtë në treg;
- Zvogëlimit në mënyrë progresive të ekonomisë joformale;
- Reformimi të sistemit arsimor dhe atij për mbrojtje sociale.
- Qeverisjes së mirë dhe transparente; dhe
- Departizimit të administratës publike.

### **Liberalizimi i vizave**

Qeveria e Kosovës synon liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe do të sigurohet për ndërmarrjen e hapave të domosdoshëm për përbushjen e këtij qëllimi. Synimi jonë është që procesin e liberalizimit të vizave ta rikthejmë nga një proces i politizuar, në proces teknik. Integriteti, kredibiliteti dhe funksionimi normal i sistemit të drejtësisë, që prodhon rezultate në luftë kundër korruptionit dhe krimit të organizuar, janë thelbësore që Kosova të liberalizojë lëvizjen e lirë të qytetarëve. Prandaj, në këtë drejtim, do të ndërmarrim iniciativat, si në vijim:

- Hapi i parë themelor dhe parakusht për funksionimin normal të sistemit të drejtësisë, është shhangja e ndikimi politik në administrimin e drejtësisë. Qeveria zotohet dhe siguron respektimin e parimeve të ndarjes së pushteteve, si vlerë themelore e rendit demokratik dhe shtetit të së drejtës.
- Në një periudhë afatshkurtër do të kompletojmë kornizën e politikave për sistemin e drejtësisë, në përputhje më standardet dhe praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.
- Ndërsa, në një periudhë afatmesme, do të zhvillojmë procesin e vetingut për sistemin e drejtësisë dhe të institucioneve të rendit dhe sigurisë publike, në

bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkomëtare dhe vendet mike, në mënyrë që të sigurojmë integritetin dhe kredibilitetin e procesit.

Meqenëse Kosova mbetet vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, që nuk gjëzon lëvizjen e lirë në Zonën Schengen, synojmë të zhvillojmë një strategji gjithëpërfshirëse për komunikim me publikun, për proceset integruese dhe liberalizimin e vizave.

## Bashkëpunimi për zhvillim

Asistëncia financiare e BE-së zbatohet nëpërmjet Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA). Për periudhën 2021-2027 Kosova do të përfitojë nga IPA III, që në total do të ofrojë mbi 14 miliardë euro për tërë vendet e rajonit. Nga IPA II (2014-2020) BE-ja fillimisht kishte planifikuar t'i ndante Kosovës 645 milionë euro, por i ndau vetëm 602 milionë euro në vitin 2018, për shkak të performancës jo të mirë të vendit. Në vitin 2019, Kosova ka humbur edhe 12 milionë euro të tjera. Performanca e dobët i ka kushtuar Kosovës rreth 60 milionë euro.

Duke pasur parasysh se fondeet e IPA III nuk do të alokohen të fiksuara për vendet e rajonit, por do të shpërndahen të bazuara në aplikimet e suksesshme të projekteve, do të intensifikojmë përgatitjen për të rritur përfitimet nga fondeet e IPA III dhe në Programet e BE-së, për të cilat Kosova do të ketë qasje në periudhën e ardhshme 2021-2027. Për t’iu përgjigjur iniciativës së BE-së për Planin për Ekonomi dhe Investime për Ballkanin Perëndimor, do të hartojmë dhe miratojmë Listën Prioritare të Projekteve Infrastrukturore, e cila do të jetë një dokument gjithëpërfshirës, që do të identifikojë projektet kryesore infrastrukturore të Kosovës për të përfituar nga fondeet e BE-së, të kombinuara me huat e ofruara nga institucionet financiare ndërkombëtare. Për më tepër, me qëllim të harmonizimit të fondeve të jashtme të ofruara për Kosovën me priorititet e saj, do të zhvillojmë dialog të strukturuar me partnerët tanë zhvillimore, me qëllim që projektet e ofruara të përgatiten bazuar në dokumentet dhe politikat qeveritare. Vëmendje e veçantë do t’i kushtojmë sfidave për realizimin e suksesshëm të projekteve dhe për këtë qëllim, do të fuqizojmë kapacitetet njerëzore të strukturave përgjegjëse në kuadër të Zyrës së Kryeministrat dhe ministrive, që kanë për detyrë identifikimin, përgatitjen dhe aplikimin për projektet, sikurse dhe zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

### 2.4.3 Qeverisje eficiente

## Rregullimi më i mirë

Për rregullim më të mirë, do të përmirësojmë mënyrën e punës, organizimit dhe funksionimit të Qeverisë, duke hartuar, përditësuar dhe harmonizuar kornizën ligjore.

Për mundësimin e planifikimit të mirë të politikave të bazuara në të dhëna, do të aplikojmë konceptin e rregullimit më të mirë, nëpërmjet kryerjes së vlerësimit të

ndikimit në mjeshtë, ndikimit social dhe ekonomik, si dhe vlerësimet e tjera për të matur rezultatin e politikave të ndërmarrë. Po ashtu, do të intensifikojmë aplikimin e vlerësimit *ex-post* të legjislacionit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtojmë ngritjes së kapaciteteve institucionale për zhvillimin e statistikave të besueshme, në përputhje me praktikat dhe standardet evropiane dhe ndërkontinentare.

### **Zvogëlimi i barrës administrative për bizneset dhe qytetarët**

Do të zvogëlojmë barrën administrative, nëpërmjet eliminimit të burokratice të tepërtë, posaçërisht nëpërmjet thjeshtimit të lejeve dhe licencave, kohës për marrjen e tyre, sikurse kohën dhe koston për shërbimet e tjera për qytetarët, në funksion të përshpejtimit të zhvillimit ekonomik. Po ashtu, do të harmonizojmë procedurat e veçanta administrative me procedurën e përgjithshme administrative. Ndërsa, do të mbështesim avancimin e funksionit të konsolidimit të akteve ligjore.

### **Komunikimi dhe konsultimi i politikave**

Qeverisja jonë do të jetë e hapur dhe transparente para qytetarëve, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile. Iniciativat dhe vendimet qeveritare do t'i bëjmë të qasshme për publikun dhe do t'i konsultojmë me të gjitha palët e interesit. Do të plotësojmë kornizën ligjore për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënieve së financimit të subjekteve politike dhe menaxhimin e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar.

#### **2.4.4 Modernizimi i administratës publike**

##### **Modernizimi i administratës publike**

Prioritet kyç i Qeverisë së Kosovës është reforma e administratës publike që synon ndryshimin rrënjosor të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve dhe krijimin e një administratë moderne dhe të aftë për përmbylljen e suksesshme të integrimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.

Do të përmbyllim kornizën e politikave në kuadër të reformës së administratës publike në përputhje me parimet, standardet dhe praktikat më të mira evropiane. Do të miratojmë një strategji e vetme e harmonizuar ndër-sektoriale për reformën e administratës publike, në përputhje me konceptin e planifikimit të integruar, që do të racionalizojë burimet dhe kapacitetet financiare dhe njerëzore.

Po ashtu, do të kompletojmë kornizën ligjore e reformës se administratës publike, duke e harmonizuar plotësisht ligjin për paga dhe ligjin për zyrtarët publikë me rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të vendoset një sistem i drejtë i pagave, që siguron pagë të njëjtë për punë të njëjtë. Po ashtu, do të finalizojmë procesin e riorganizimit të administratës shtetërore në përputhje me legjislacionin e ri.

##### **Forcimi i integritetit institucional, llogaridhënieve së ngritjes së kapaciteteve**

Do të zhvillojmë një sistem kredibil dhe transparent të ngritjes së kapaciteteve në shërbimin civil, që siguron rekrutimet dhe avancimet të bazuara në meritokraci dhe që ofron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët. Për më tepër, do të zbatojmë praktikat më të mira për rekrutimin në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil, duke siguruar integritetin e procesit të rekrutimit të këtyre pozitave. Në këtë drejtim, do të avancojmë sistemin e vlerësimit të performancës dhe do të zhvillojmë sistemin e inspektimeve në shërbimin civil me qëllim të ngritjes së llogaridhënieve dhe ofrimit të rezultateve.

Ndër të tjera, do të vazhdojmë të zhvillojmë skema të veçanta të profesionalizimit të shërbimit civil, duke vazhduar rekrutimin e të diplomuarve nga Skema e Profesionistëve të Rinj, si dhe do të angazhohemi për zhvillim e skemave të tjera të aftësimit për administratën publike dhe për sektorët e tjera, duke u bazuar në përvojat e mira me partnerët zhvillimorë. Njëkohësisht, do të zhvillojmë politika stimuluese për ruajtjen e stafit të specializuar, do të ngrisim kapacitetet dhe do të mundësojmë zhvillimin e karrierës përmes edukimit dhe trajnimit cilësor.

Në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Republikës së Kosovës, do të përballym procesin e racionalisht të agjencive dhe organeve të pavarura nëpërmjet kompletimit, miratimit dhe zbatimit të kornizës ligjore përkatëse. Për këtë proces, do të sigurojmë vija të qarta të llogaridhënieve, transparencës dhe efektivitetit të institucioneve që ofrojnë shërbime.

#### **2.4.5 Digjitalizimi për shërbime më të mira**

Do të shtojmë aplikimin e qeverisjes elektronike që të rrisë kapacitetin, qasshmërinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve. Në funksion të rritjes së ndërveprueshmërisë institucionale, do të përmirësojmë standartet për ndërlidhjen e sistemeve dhe do të investojmë në infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë informative, me qëllim të ndërlidhjes graduale të regjistrave të ndryshëm dhe sistemeve. Do të funksionalizojmë portalin e-Kosova, si pikë kontakti, nëpërmjet të cilit qytetarët dhe administrata mund të marrin informata, të aplikojnë për shërbime dhe të marrin shërbimin online pa pasur nevojë për prani fizike.

Me qëllim të uljes së kohës dhe kostos për qytetarët, bizneset dhe administratën, nëpërmjet ndërveprueshmërisë institucionale, do të ndjekim parimet “once only”, “personalisation” dhe “digital by default”. Ndër të tjera, proceset e rekrutimit dhe avancimit të brendshëm dhe format e pagesave në administratën publike, do t'i ofrojmë online, nëpërmjet e-testimeve, nënshkrimit elektronik dhe e-pagesës. Për këtë, do të ngrisim kapacitetet e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, do të krijojmë Qendrën e Rimëkëmbjes së të Dhënave Elektronike, do të zgjerojmë dhe avancojmë kapacitetet e rrjetit shtetëror kompjuterik, përfshirë atë pa tela (wifi), si dhe do të sigurojmë vazhdimësinë e shërbimeve digitale në raste emergjente.

Për mundësimin dhe lehtësimin e qasjes dhe përdorimit e të dhënave, do të themelojmë qendra shumëfunksionale për qytetarët. Gjithashtu, do të sigurojmë koordinimin ndërinstitucional për të zhvilluar dhe zbatuar politikat për qeverisjen digitale. Në këtë drejtim, do të punojmë në funksionalizimin e plotë të kornizave strategjike, ligjore, institucionale dhe teknike për shërbimet elektronike. Dokumentet kryesore strategjike që do të zhvillohen përfshinë e digitalizimit, do të përmbajnë masa konkrete sa i përket sigurisë së shërbimeve elektronike, si dhe do të përgatisim agjendën digitale të Kosovës, e cila do të përmbajë objektiva, të cilat synojnë zhvillimin e qeverisjes elektronike, jo vetëm në administratën publike, por edhe në sektorët tjera.

#### **2.4.6 Reformat në financa publike dhe prokurim publik**

Do ta avancojmë reformën e menaxhimit të financave publike nëpërmjet miratimit të Strategjisë së re përketyet fushë. Do të rishikojmë kornizën ligjore përmenaxhimin e financave publike dhe kornizës ligjore përmenaxhimin e politika fiskale, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënieve, si dhe përruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale.

Nëpërmjet reformave në sistemin e prokurimit publik, synojmë ta bëjmë shpenzimin e fondeve publike në mënyrë efikase dhe transparente. Po ashtu, do të rishikojmë kornizën ligjore përmenaxhimin e prokurimit publik, përmenaxhimin e standardet e BE-së. Do të fuqizojmë prokurimit elektronik dhe ndërlidhjen me SIMFK, përmenaxhimin e buxhetimit dhe shpenzimit të përgjegjshëm. Në kontekst të reformave në prokurimin publik, do ta funksionalizojmë Modulit e Menaxhimit të Kontratave, nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, si dhe modulin përmenaxhimin e performancës të operatorëve ekonomik në sistemin e e-prokurimit, funksional përmenaxhimin e gjitha llojet e kontratave.

#### **2.4.7 Ndërmarrje publike të qëndrueshme dhe me shërbime cilësore**

Do të përmirësojmë qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike, me anë të përmirësimit të performancës dhe cilësisë së shërbimeve së tyre, përmenaxhimin e bizneset. Përmenaxhimin e cilësisë së shërbimeve së tyre, përmenaxhimin e rezultateve, përmenaxhimin e performancës së qeverisjes së ndërmarrjeve publike. Po ashtu, do të rishikojmë kornizën ligjore dëshmorëve të qeverisjes së ndërmarrjeve publike. Po ashtu, do të rishikojmë kornizën ligjore dëshmorëve të qeverisjes së ndërmarrjeve publike.

Po ashtu, do të bëjmë investimet e domosdoshme në ndërmarrje publike përkatëse, duke u bazuar në studime paraprake.

#### **2.4.8 Qeverisja Lokale**

Vizioni ynë është krijimi i qeverisjes lokale të qëndrueshme, të hapur dhe me mundësi për të gjithë, të cilën synojmë të arrijmë me anë të rritjes së autonomisë lokale dhe forcimit të aftësisë së komunave për shërbime më të mira.

### *Avancimi i politikave dhe kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale*

Për zhvillimin e nivelit lokal, do të rishikimin funksional të sistemit të vetëqeverisjes lokale, nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Financat e Pushtetit Lokal dhe Zgjedhjet Lokale. Me qëllim që të kemi një shoqëri më të integruar, do të promovojmë të drejtat të njeriut në nivel lokal, me theks të veçantë për grupet e marginalizuara. Për mbështetjen e zhvillimit ekonomik të komunave, do hartojmë ligjin për Grantin e Katërt Qeveritar dhe ligjin për sistemin e menaxhimit të performancës dhe skemës së grantit për performancë kommunale.

### **Granti i Katërt për komuna**

Do t'u mundësojmë komunave autonomi për investime kapitale, nëpërmjet *Grantit të katërt*. Do të hartojmë kornizën ligjore, ku do të vendosim kriteret profesionale, të cilat u mundësojnë komunave të konkurrejnë me idetë dhe projektet e tyre për zhvillim të gjithanshëm, në sektorë si turizmi rural, inovacioni, sportet, trashëgimia kulturore, arti, infrastruktura publike, sistemet e ngrohjes qendrore, furnizimi me ujë të pijshëm, mbarështimi dhe ripërtëritja e hapësirave të dëmtuara dhe trajtimi i ujërave të zeza. për ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët. Për të arritur këtë, do të hartojmë Ligjin për Grantin e Katërt.

### *Zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik i komunave*

Ndër priorititet tona është identifikimi dhe adresimi i problemeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19 në nivelin institucional, ekonomik, social, arsimor, kulturor në nivelin komunal. Për këtë qëllim, do të ndihmojmë komunat për zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë duke ofruar rritje të mundësive socio-ekonomik për biznese dhe për të rinjtë e marginalizuar në komuna.

### *Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar*

Do të angazhohemi për zbatimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të mbështetura nga BE, nëpërmjet krijimit dhe avancimit të strukturave për zbatimin e fondeve në kuadër të IPA, si dhe rritjes së e përfomancës komunale përmes matjes, vlerësimit dhe mbështetjes financiare për komuna.

### *Rritja e transparencës, llogaridhënieve dhe përmirësimi i shërbimeve*

Do të promovojmë qeverisjen e hapur, nëpërmjet të cilës do të rrisim transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Do të përmirësojmë shërbimet nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve, siç është zhvillimi i platformës shtetërore E-KOMUNAT, si dhe zhvillimit të kapaciteteve komunale për sektor të veçantë të planifikimit, vlerësimit dhe monitorimit, në kuadër të projekteve brenda MAPL-së.

## **2.5. Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore**

### *Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut*

Do të punojmë për një shoqëri me diversitet dhe gjithëpërfsirje dhe me mundësi për të gjithë. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet fuqizimit e rolit të gruas në shoqëri, ekonomi dhe në trashëgimi, përmirësimin e cilësisë së mirëqenies të jetës së fëmijëve, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara si dhe përmirësimin e gjendjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke promovuar dhe respektuar diversitetin dhe barazinë.

### *Sigurimi i barazisë gjinore nëpërmjet fuqizimit të gruas*

Do të angazhohemi në kompletimin e kornizës ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore. Në koordinim me institucionet përgjegjëse të sundimit të ligjit, do të angazhohemi për të ngritur kapacitetet e mekanizmave institucionale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, do të bëjmë analizë e situatës dhe do të krijojmë modelin e kostos ekonomike për rritjen e efikasitetit funksional të strehimoreve, për mbrojtje nga dhuna në familje.

Politikat e reja që do t'i hartojmë, do t'i nënshtronen edhe vlerësimit të ndikimit gjinor, në mënyrë që të kemi një vendimmarrje të informuar sa i përket avancimit të politikave gjinore, si dhe do të avancojmë politikën e buxhetimit gjinor. Po ashtu, do të angazhohemi në fuqizimin ekonomik të gruas në shoqëri dhe ekonomi, nëpërmjet mbështetjes financiare, dhe masave affirmative sikurse regjistrimi i pronës. Më konkretisht, do të zbatojmë masa affirmative në bashkëpunim me regjistrimin e pronës dhe komunat, për ndërgjegjësimin e qytetarëve për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. Ndër të tjera, do të mbështesim iniciativat e reja që fuqizojnë pozitën e gruas në shoqëri nëpërmjet subvencionimit të OJQ-ve dhe iniciativave individuale.

## **2.6. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve**

Do të punojmë për një shoqëri të drejtë, të barabartë, për krijimin e kushteve për jetë të dinjitetshme, integrim dhe zhvillim të secilit komunitet.

Në qeverisjen tonë nuk do të ketë vend për diskriminim në punësim, arsim apo mbështetje për ndërmarrësit, për komunitetet joshumicë. Komuniteteve joshumicë do t'u hapim të gjitha rrugët dhe mundësitet që të ndihen dhe të jenë, jo vetëm të barabartë me secilin qytetar tjetër, por edhe bashkëpronar të progresit tonë në ekonomi dhe shoqëri. Do të angazhohemi për shkollimin dhe aftësim në të gjitha nivelet e fëmijëve e të rinjve nga komunitetet romë, ashkali e egjiptas. Ndër të tjera, do të shtojmë numrin e mësimdhënësve nga radhët e komuniteteve në nevojë.

### *Përmirësimi i politikave për komunitetet*

Do të kompletojmë kornizën ligjore dhe strategjike nëpërmjet hartimit të Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre, koncept dokumentit për personat e zhvendosur, hartimit të Ligjit për Personat e Zhvendosur, mbi parimet e të drejtave themelore dhe pa përjashtim të asnjë komuniteti.

### *Përfshirja sociale dhe stabilizimi i përgjithshëm i komuniteteve në Kosovë*

Do t'i mbështesim komunitetet për zhvillimi ekonomik dhe integrimit kulturor e shoqërор nепермjet projekteve тe cilat janë нe funksion тe kthimit, riintegrimit dhe stabilizimit тe komuniteteve, mbështetjes financiare тe shoqërisë civile me qëllim тe krijimit besimit тe ndërsjellë нe mes тe komuniteteve, me anë тe Projektit "Programi i KE-së për Stabilizimin e Komuniteteve IV" për тe krijuar gjenerimin e тe ardhurave dhe mundësитe e punësimit midis komuniteteve pakicë нe тe gjitha regjionet, dhe nепермjet përfshirjes sociale dhe stabilizimit тe përgjithshëm тe komuniteteve нe Kosovë.

### *Kthimi i personave тe zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme*

Do тe angazhohemi për kthimin e personave тe zhvendosur nепермjet rindërtimit dhe rinovimit тe shtëpive тe тe gjithë komuniteteve, zhvillimit тe projekteve infrastrukturore нe bashkëpunim ndërmjet nivelit qendror dhe lokal si dhe ngritjes сe Sistemit te Menaxhimit te Informacionit për personat e zhvendosur. Po ashtu, do t'u ofrojmë ndihmë shtetasve тe Republikës сe Kosovës, тe interesuar për kthimin нe vendbanimet e tyre, personave тe zhvendosur që jetojnë нe qendrat kolektive, shtëpive private dhe kthimin e shqiptarëve нe Veri тe Mitrovicës.

## **2.7. Rritje gjithëpërfshirëse ekonomike**

Vizioni ynë është ndërtimi i sistemit të qëndrueshëm të financave publike në përputhje me standartet më të larta ndërkombëtare, që siguron rritje dhe zhvillim ekonomik, si dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët. Këtë do ta arrijmë nëpërmjet ridisejnimit të politikave fiskale dhe të sistemit financier, që siguron llogaridhënie.

### **2.7.1 Sigurimi i qëndrueshmërisë së financave publike**

Për sigurimin e qëndrueshmërisë së financave publike, do të angazhohemi në rritjen e llogaridhënieve efikasitetit, nëpërmjet rritjes së transparencës mbi borxhin publik, fuqizimit të prokurimit elektronik dhe ndërlidhjes me sistemin informativ, me qëllim të sigurimit të buxhetimit dhe shpenzimit të përgjegjshëm. Do të rishikojmë dhe kompletojmë kornizën ligjore për politikat fiskale, të cilat rregullojnë financat publike, ndihmën shtetërore, financat e pushtetit lokal, doganat dhe tatimet. Po ashtu, do të kompletojmë kornizën ligjore në sektorin financier për institucionet mikrofinanciare dhe jobankare, sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, sigurimin e depozitave për institucionet financiare, kambialin, premtim pagesën dhe bankat.

### **2.7.2 Rimëkëmbja Ekonomike - krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik**

Nxitja e punësimit të qëndrueshëm është synim afatgjatë i qeverisjes sonë, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet disejnimit të skemës për rikthimin në punë të personave që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë. Do të mbështesim të punësuarit e rinj për periudhën e rimëkëmbjes ekonomike si dhe do të krijojmë një skemë për punësimin e garantuar për të rinjtë. Po ashtu, do të punojmë për ndërlidhjen e tregut të punës dhe arsimit profesional, nëpërmjet krijimit të sistemit informativ për tregun e punës, zgjerimit të shërbimeve të punësimit dhe aftësimit profesional me shërbime të reja, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me sindikatat. Po ashtu, do të punojmë për rritjen e punësimit të grave, me fokus në të bërit biznes, krijimin e kushteve të favorshme të të bërit biznes dhe thjeshtimin e procedurave për eksport dhe import.

Për sigurimin e financimit të planit për zhvillim ekonomik, do të angazhohemi në negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare financiare dhe emetimin e letrave me vlerë.

### **2.7.3 Ridisejnimi i politikave fiskale**

Për sigurimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike, do të ridisejnojmë politikat fiskale. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet rishikimit të politikave aktuale fiskale dhe zbatimit të politikave të reja, që përfshijnë analiza të sistemit tatimor, rishikimin e formatit të tatimit për bizneset e vogla dhe të mesme, ndryshimin e formës së deklarimit të tatimit

në të ardhura personale dhe vendosjen e obligimit për deklarimin vjetor të tatimit në të ardhura personale.

#### **2.7.4 Formalizimi i ekonomisë**

Për luftimin e ekonomisë jo-formale, do të angazhohemi në përmirësimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes ekonomike në Kosovë, me qëllim të rritjes së të ardhurave tatimore, si dhe formalizmit të punësimit. Për këtë qëllim, do të rishikojmë Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kundër Ekonomisë Joformale dhe Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2019-2023.

Situata e krijuar në Kosovë nga pandemia COVID-19, ka ndikuar në mbylljen e shumicës së bizneseve për një periudhe dy-tre mujore. Pasojat e pandemisë ndjehen edhe sot në ekonominë e vendit si humbja e vazhdueshme e vendeve të punës, rënia e aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht rritje të shkallës së varfërisë, që karakterizohet në masë të madhe me uljen e fuqisë blerësve dhe uljen e qarkullimit dhe uljen e të hyrave buxhetore.

Me qëllim të luftimit të ekonomisë joformale, do të fuqizojmë kapacitetet e inspektorëve tatimore, aftësitë hetimore dhe të inteligjencës dhe koordinimin më të mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe ndalimin e punës së padeklaruar.

## **2.8. Industria, ndërmarrësia dhe tregtia**

Vizioni jonë është përmirësimi i konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet avancimit të politikat në sektorin e industrisë, investimeve, ndërmarrësisë dhe tregtisë dhe përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë të cilësisë, në atë mënyrë që ndërmarrjet tona të janë konkuruese në rajon dhe më gjërë. Këto do të arrihen në pajtueshmëri me obligimet e Kosovës për zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim.

### **2.8.1 Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes**

Për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimit të konkurrueshmërisë, do të avancojmë kornizën ligjore për konkurrencën, shoqëritë tregtare dhe përmirësimin e regjistrave të bizneseve për të mundësuar një administrim efikas të tatimeve, menaxhim efektiv të pajtueshmërisë dhe ofrimin e statistikave të duhura. Kodin për qeverisje të korporatave. Do të përfundojmë reformën e përgjithshme të inspektimeve, nëpërmjet miratimit të ligjit për inspekte, e cila, ndër të tjera, përfshin zhvillimin e platformës digitale për inspekte, rishikimin e organizimit funksional të njësive inspektuese, ndërlidhjen e bazës së të dhënavës dhe rritjen e numrit të inspektorëve.

Po ashtu, do të kontrollojmë tregtinë e mallrave strategjike dhe do të finalizojmë e funksionalizojmë bazën e të dhënavës, licencimin dhe regjistrimin elektronik të operatorëve që tregtojnë mallra strategjikë. Për përmirësimin e performancës në mbështetje të sektorit privat dhe zhvillim të ndërmarrjeve, do të ristrukturojmë dhe ngrisim kapacitetet e agjencive ekzekutive për promovim të investimeve. Në këtë drejtim, do të mundësojmë ndërveprueshmërinë e sistemeve për menaxhim të informatave dhe ristrukturim të skemave të granteve për përkrahjen e NVM-ve.

Qeveria do të mbështet bizneset në blerjen e makinerisë prodhuese dhe përpunuese, duke synuar digitalizimin e procesit të përpunimit dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe prodhuese, ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Gjithashtu, do t'i ndihmojë bizneset në gjetjen e tregjeve për eksport.

Do të mbështeten bizneset prodhuese me potencial per eksport dhe krijim të vendeve të punës, avancimin e teknologjisë prodhuese dhe përpunuese, duke përfshirë transformimin digital, për të mundësuar rritjen e vlerës së produktit, me trajtim të veçantë bizneset në pronësi nga gratë.

### **2.8.2. Zhvillimi i qëndrueshmëm nëpërmjet turizmit**

Me qëllim të avancimit të politikave për turizmin, do të miratojmë Strategjinë për Zhvillimin e Turizmit dhe do të rishkojmë Ligjin për Turizmin. Për shfrytëzimin e turizmit për zhvillim ekonomik, do të angazhohemi për integrimin e trashëgimisë kulturore dhe kulturës e sportit në politikat e reja qendrore dhe lokale. Nëpërmjet

këtyre politikave, synojmë rritjen e kontributit të turizmit kulturor e sportiv në PBV të Kosovës.

Për të shfrytëzuar potencialet e turizmit natyror dhe kulturor si qelës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, do te zhvillojmë ofertën turistike dhe zinxhirin e vlerës me fokus në trashëgimi kulturore, turizmin rural, agroturizëm përfshirë vreshtarinë dhe artizanatet. Fokus të veçantë do të ketë turizmi malor përfshirë resorët e skijimit, rritjen e kapaciteteve akomoduese, njerëzore dhe përmirësimin e infrastrukturës përkatëse.

Ndër të tjera, do të punojmë në digitalizimin e destinacioneve turistike. Me qëllim të promovimit të trashëgimisë kulturore, do të funksionalizojmë monumentet përfshirë funksione të ndërlidhura me industrinë e turizmit, do të hartojmë planet ndër sektoriale për zonat me interes të veçantë, do të revitalizojmë monumentet e restauruara dhe do t'i hapim përfshirë shfrytëzim.

### **2.8.3. Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe inovacionit**

Qeveria do të zhvillojë më tutje politikat dhe kornizën ligjore përfshirë inovacion dhe ndërmarrësi. Do te ndërtojmë bashkëpunim te strukturuar ne mes akterëve qeveritar, industrial dhe të arsimit dhe aftësimit profesional, me qëllim të përafrimët të programeve të arsimit dhe aftësimit me nevojat e tregut.

Stimulimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit si një prioritet i qeverisjes sonë, do ta bëjmë nëpërmjet ristrukturimit të programit ekzistues përfshirë "Fondin përfshirë Inovacion dhe Ndërmarrësi". Do të mbështesim rritjen e kapaciteteve të hapësirës së inkubacionit dhe ofrimit të mundësive përfshirë rindërtim, me qëllim që inkubatorët të mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve fillestare, të cilat do të térheqin investitorët vendas dhe të huaj, duke rezultuar në krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomik. Do të ndajmë grante përfshirë ndërmarrjet fillestare me qëllim térheqjen e ideve inovative, me potencial përfshirë eksport dhe krijimin e punësimit. Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet shfrytëzimit efikas te Parkut te Inovacionit dhe Trajnimit ne Prizren dhe Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, të finançuara nga buxhetit qeveritar.

Njëkohësisht, do të shqyrtojmë mundësinë e përfshirjes së lëndëve të ndërmarrësisë në arsimin e mesëm të ulët dhe do te ndërtojmë laboratorë shtesë përfshirë mbështetjen e studentëve në praktike.

### **2.8.4. Promovimi dhe përkrahja e investimeve**

Për promovimin e investimeve, do të ndërmarrim masa përfshirë krijimin e një qasjeje (procesi) të unifikuar dhe strukturuar qeveritar, nëpërmjet zhvillimit të një politike kombëtare me parime dhe kriterë te qarta për térheqjen e investimeve. Do të rishikojmë kornizën ligjore përfshirë investime strategjike, përfshirë zonat ekonomike dhe përfshirë investimet e huaja. Krahas reformës institucionale dhe politikëbërjes përfshirë promovimin

e investimeve, si pjesë e kërkesës së Agjendës për Reforma Evropiane, do të vendosim programin e kujdesit pasues për investimet.

Po ashtu, do të bëjmë një analizë rreth funksionimit të zonave ekonomike, në atë mënyrë që investimet të bëhen në konsultim të ngushtë me bizneset. Do të krijohen zona të reja ekonomike sipas nevojës dhe për qëllime të krijimit të qendrave për transfer të teknologjisë dhe parqe teknologjike. Në këtë aspekt, vëmendje e veçantë do t'i kushtojmë përfshirjes së diasporës në investime, me anë të organizimit të konferencave dhe sesioneve informuese, krijimit e fuqizimit të rrjeteve të afarizmit me investitor potencial, duke hulumtuar dhe përcaktuar vendet me potencial për të promovuar mundësitë për investime.

#### **2.8.5. Zhvillimi i politikave industriale dhe tregtarë**

Do të përmirësojmë politikat industriale, nëpërmjet përmirësimit të dialogut publiko privat dhe analizës së zinxhirit të vlerës për sektorët kyç industrial. Bashkëpunimi i strukturuar me komunitetin e bizneseve dhe analizat e sektorëve industrial do ta ndihmojnë zhvillimin e politikës industriale të bazuar në evidencë për sektorët me potencial të zhvillimit industrial, krijim të vendeve të punës dhe rritje të eksportit.

Në fushën e tregtisë, do të avancojmë kornizën ligjore për tregti të brendshme, atë të jashtme dhe tregtisë elektronike. Po ashtu, do të përmirësojmë dhe miratojmë kornizën ligjore që rregullon tregun e naftës si dhe mundëson krijimin e rezervës së obliguar të naftës, ne harmoni me direktivat e BE-së.

Për integrimin tregtar rajonal dhe obligimeve që ka Kosova në nisma të ndryshme, do të punojmë në harmonizimin e protokolleve shtesë V dhe VI të CEFTA-s dhe do të negociojmë protokollin shtesë VII. Po ashtu, do të rishikojmë marrëveshjet aktuale, duke negociuar dhe liberalizuar më tutje edhe tregun e shërbimeve. Qeveria synon të ngris kapacitetet institucionale me qellim te përmirësimi te përfaqësimit në rajon dhe ndërkombëtar, funksionalizimit te pikës së vetme të kontaktit për shërbime në kuadër të Direktivës së Shërbimeve. Aplikimi dhe negocimi për anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë.

#### **2.8.6 Përmirësimi i infrastrukturës së cilësisë, përfshirë mbrojtja e konsumatorit**

Ndër të tjera, do të përafrojmë politikat dhe legjislacionin me direktivat e BE-së për infrastrukturën e cilësisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e përgjithshme të produkteve. Do të përmirësojmë legjislacionin e akreditimit dhe metrologjisë dhe do të fuqizojmë kapacitetet e metrologjisë, akreditimit dhe standardizimit. Këto reforma do t'i arrijmë me anë të përmirësimit të infrastrukturës së punës, digitalizimit, rritjes së kapaciteteve njerëzore, si dhe rritjes së numrit të laboratorëve, akreditimin e tyre, si dhe nëpërmjet anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Në kuadër të përmirësimit të politikave dhe kornizës ligjore, do të rishikojmë Ligjin për Sekretet Tregtare, Ligjin për Patenta, Ligjin për Dizajnin Industrial dhe Ligjin për

Marka Tregtare. Po ashtu, do të punojmë në ngritjen e kapaciteteve, në mënyrë që të mbrojmë pronësinë industriale nëpërmjet trajtimit të zyrtarëve në fushën e pronësisë industriale, përfshirë edhe ata të API-së, gjyqtarët, prokurorët dhe policinë.

## **2.9. Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve të TIK**

Do të zhvillojmë infrastrukturën dhe kapacitetet e sektorit të TIK-ut, si potential për zhvillim ekonomik, nëpërmjet avancimit të ekonomisë digitale dhe kapitalit njerëzor. Do të hartojmë Agjendën e re Digitale të Kosovës, duke ndjekur praktikat dhe trendët më të mira ndërkombëtare.

Po ashtu, do të punojmë në infrastrukturën fikse brezgjerë dhe atë mobile 5G. Do të mundësojmë identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike dhe do të zhvillojmë sistemin e Identifikimit Elektronik për qytetarët dhe bizneset. Rëndësi të veçantë do t'i kushtojmë trajnimit të të rinjve në fushën e teknologjisë informative dhe qasjes së tyre në mundësi punësimi edhe në formën online.

Ndër të tjera, do të promovojmë bashkëpunimin publiko-privat, nëpërmjet projekteve kapitale si Parku i Teknologjisë Digitale në Bërnicë dhe funksionalizimit të Qendrës për Ekselencë Digitale, në Parkun për Inovacion dhe Trajnim në Prizren.

## **2.10. Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural**

Vizioni ynë është zhvillimi bujqësor që përmirëson jetën rurale dhe ndërton një ekonomi të qëndrueshme, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet reformës dhe nxitjes së konkurrencës, inovacionit dhe investimeve të reja.

### **2.10.1 Reformat gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për shërbime më efikase**

Do të reformojmë sektorin e bujqësisë, nëpërmjet eliminimit të keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit të deritashëm. Do të riorganizojmë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, do të ristrukturojmë dhe avancojmë Institutin Bujqësor të Kosovës (IBK), Agjencinë së Pyjeve të Kosovës dhe Agjencisë për Zhvillim të Bujqësisë, përfshirë edhe akreditimin e kësaj të fundit. Do të reformojmë dhe zhvillojmë sistemin për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve, do të zhvillojmë sistemin e kontrollit në IBK, do të avancojmë regjistrin dhe kontrollin e produkteve bujqësore dhe do të unifikojmë numrin identifikues të fermës (NIF) me agjencinë e statistikave dhe atë të ushqimit dhe veterinës. Do të fuqizojmë transparencën dhe llogaridhëni nëpërmjet fuqizimit dhe krijimit të mekanizmave përkatës, si dhe zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

### **2.10.2. Rritja e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor**

Për rritjen e konkurrencës në sektorin agro-ushqimor, do të ndërmarrim reforma të thella nëpërmjet hartimit të Programit dhe Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në pajtim me politikat e përbashkëta bujqësore (PPB). Po ashtu, do të rishikojmë kornizën ligjore për bujqësi dhe zhvillim rural, për ushqimin dhe për regjistrimin e bujqësisë. Me qëllim të uljes së barrës administrative, përkatësisht thjeshtimit të lejeve dhe licencave, do të rishikojmë kornizën ligjore përkatës.

Ndër të tjera, do të mbështesim zhvillimin e bizneseve të reja dhe promovimin e produkteve bujqësore, duke organizuar tregun e përbashkët për produktet bujqësore (sigurimin e çmimeve minimale për produktet bujqësore) dhe funksionalizimin e fondit për sigurime bujqësore. Do ta zhvillojmë sektorin agro-ushqimor paralelisht me nevojën e shkathtësive në industrinë e ushqimit, duke zhvilluar standarde profesionale.

### **2.10.3 Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (tokës bujqësore, pyjeve dhe ujit për ujitje)**

Për menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore, do të rishikojmë Ligjin për Tokën Bujqësore, Ligjin për Rregullimin e Tokës Bujqësore dhe Ligjin për Pyjet. Duke marr parasysh se kemi një tokë bujqësore tejet të fragmentuar, do t'i inventarizojmë tokat bujqësore. Do të miratojmë strategjisë për sektorin e pylltarisë dhe do të fuqizojmë mekanizmat institucional për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve.

Po ashtu, do të orientohemi në sistemet e ujites së tokave bujqësore duke bërë rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujites dhe njëkohësisht duke ruajtur ambientin. Ndër të tjera, do të bëjmë studimet e fizibilitetit të projekteve të ujites, të bazuara në Planin për Ujiten e Tokave Bujqësore.

#### **2.10.4 Mbështetje e bizneseve në zhvillimin e zonave rurale**

Në mbështetje të zhvillimit të zonave rurale, do të përgatisim masat për diversifikimit e fermave dhe zhvillimi e biznesit në këto zona. Do të mbështesim bizneset në zhvillimin e turizmit rural, përpunimin e prodhimeve bujqësore në ekonomitë familjare, zhvillimin e akuakulturës në zonat rurale dhe aktiviteteve artizanale.

#### **2.10.5 Siguria e ushqimit**

Do të avancojmë politikat e sigurisë së ushqimit dhe përafrimin e tyre me standarde e BE-së. Ato kanë për qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve, mirëgenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve. Në këtë drejtim do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë hartimit të kornizës ligjore për ushqimin e sigurt dhe sigurinë ushqimore dhe kornizës ligjore për luftimin dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, qarkullimin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, si dhe kompletimit të kornizës ligjore për prodhimin, tregtimin, kontrollin, regjistrimin e prodhuesve dhe treguesve të farërave dhe kornizës ligjore për prodhimin, tregtimin, kontrollin, regjistrimin e prodhuesve dhe treguesve të materialit fidanor.

Po ashtu, do të plotësojmë kornizën ligjore për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor. Ndër të tjera, do të angazhohemi për funksionalizimin e fabrikës për trajtimin e nën-produkteve shtazore.

## **2.11. Zhvillimi rajonal**

Vizioni ynë është zhvillimi i balancuar dhe i qëndrueshëm rajonal, me rritje të kohezionit socio-ekonomik e territorial. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet zhvillimit të politikave dhe programeve për zhvillim rajonal dhe stimulimin e bashkëpunimit ndër rajonal, me synim të zvogëlimit të pabarazive rajonale.

### **➤ *Kompletimi i politikave për zhvillim socio-ekonomik rajonal***

Do të kompletojmë politikat për zhvillim socio-ekonomik rajonal dhe do të definojmë fushat e zhvillimit rajonal, nevojat dhe koordinimin e investimeve, punën dhe funksionimin e mekanizmave, që do të shërbejnë për një zhvillim rajonal socio-ekonomik të balancuar. Po ashtu, do të ndërmarrim veprimet dhe procedurat e nevojshme për hartimin e Ligjit për Zhvillim Rajonal, themelimin e mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, si dhe do të bëjmë analizën mbi vlerësimin e fushave të nevojshme për investime me ndikim rajonal.

### **➤ *Zvogëlimi i pabarazive rajonale***

Zvogëlimi i dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik dhe ngritja e cilësisë së jetës në rajone zhvillimore, nuk mund të arrihet pa ngritjen e kapaciteteve të rajoneve, në mënyrë që të kenë një konkurrencë të mirëfilltë ndër rajonale. Për këtë, do të ndërmarrim masa për përcaktimin e prioriteteve në bazë të vlerësimeve për zhvillim socio-ekonomik të rajoneve, krijimin e data bazës për inventarizimin e resurseve natyrore, ekonomike dhe kulturore sipas rajoneve zhvillimore dhe analizën e shpërndarjes se granteve në sektorin privat nga niveli qendror në rajone, në mënyrë që të arrijmë nivele më të larta të produktivitetit dhe punësimit.

### **➤ *Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal dhe transnacional***

Do të zgjerojmë bashkëpunimin ndër-rajonal, do të rrisim pjesëmarrjen në nismat trans-nacionale dhe do të mundësojmë përfshirjen në programet e ndryshme të BE-së, që kanë të bëjnë me zhvillim rajonal, siç janë BALKANMED, ADRION, DANUB.

## **2.12. Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor**

Vizioni jonë është planifikimi dhe investimet cilësore, me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe infrastrukturës së integruar në harmoni me mjedisin e pastër, mirëqenien dhe mobilitetin.

### **2.12.1 Përmirësimi i cilësisë së ajrit**

Do të angazhohemi për përmirësimin e ajrit dhe resurseve natyrore nëpërmjet kompletimit të kornizës ligjore dhe rishikimit të kornizës strategjike. Në kuadër të përmirësimit të kornizës strategjike do të miratojmë Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe udhëzimin administrativ për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes. Po ashtu, do të përgatisim dhe lansojmë portalin kombëtar për cilësinë e ajrit. Me qëllim të ndërmarrjes së masave kundër ndotjes, do të bëjmë vlerësime për identifikimin e burimeve të ndotjes së ajrit për gjithë territorin e vendit. Po ashtu, do të plotësojmë kornizën strategjike me miratimin e Strategjisë për Zhvillim të Qëndrueshëm Mjedor. Për adresimin e ndotjes së ajrit në zona të caktuara, do të hartojmë masat e kontrollit të ajrit për Prishtinën, për zonat tjera të rëndësishme të angloerateve dhe për zonat të ndjeshme.

### **2.12.2 Menaxhimi i integruar i mbeturinave**

Do të miratojmë Strategjinë për menaxhimin e integruar të mbeturinave, nëpërmjet së cilës synojmë një planifikim dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e vlerave e praktikave të një ekonomie qarkore në shkallë vendi. Kjo qasje do të mundësojë zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm, që është i nevojshëm për shëndetin publik, zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Po ashtu, do të plotësojmë kornizën ligjore për mbeturina, duke përfshirë edhe Ligjin për Mbeturina nga Industria e Nxjerrjes së Mineraleve. Ndër të tjera, do të punojmë në përmirësimin e infrastrukturës fizike për mbeturina, nëpërmjet zgjerimit të deponive të mbeturinave, konsolidimit të kompanive publike për mbledhjen e mbeturina, ndërtimit të qendrave të transferimit dhe riciklimit, ndërtimit të impianteve për trajtim të ujërave të zeza dhe funksionalizimit të puseve për monitorim të ujërave nëntokësor. Për këtë, do të fuqizojmë mekanizmat inspektues, nëpërmjet trajnimit të inspektorëve, ndalimit të aktiviteteve të jashtëligjshme për shfrytëzim të resurseve minerare dhe do të mbikëqyrim gjendjen e mbeturinave të rrezikshme.

### **2.12.3 Menaxhimi i ujërave dhe ngritja e infrastrukturës**

Menaxhimi efektiv i resurseve ujore është parakusht për sigurimin e ujit në sasi të mjaftueshme, në cilësi të duhur si dhe në kohën dhe vendin e duhur, për nevojat e popullatës dhe të zhvillimit ekonomik. Rrjedhimisht, menaxhimi efektiv i resurseve ujore ka rëndësi thelbësore për mirëqenien sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm të

çdo vendi. Me qëllim të arritjes së objektivave themelore sa i përket menaxhimit të resurseve ujore, që janë, mbrojtja e ujërave, mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe shfrytëzimi eficient i ujërave, do të përmirësojmë kornizën ligjore të ujerave, ku hyn rishikimi i ligjit për ujëra apo hartimi i një ligji të ri, kompletimi i akteve nënligjore që kërkohen për zbatimin e ligjit, sidomos rrëth koncesionit, si dhe hartimi i ligjit për financimin e menaxhimit të resurseve ujore. Po ashtu, do të hartojmë planet për menaxhimin e pellgjeve lumore, studimet e fizibilitetit për lokacionet për akumulimin e ujërave dhe do të bëhet vlerësimi i sigurisë së digave ekzistuese.

Ndër të tjera, do të angazhohemi në mbrojtjen e resurseve ekzistuese ujore nga tej shfrytëzimi, eksplorimi, ndotjet industriale, do të vendosim rregullat në dhënien e së drejtës ujore, si dhe do të konsolidojmë institucionet për menaxhimin e ujërave.

#### **2.12.4 Mbrotja e natyrës dhe biodiversitetit**

Do të angazhohemi për mbrojtjen e natyrës nëpërmjet rishikimit të kornizës ligjore dhe kornizës strategjike. Në kuadër të këtij rishikimi, do të hartojmë Ligjin për Mbrotjen e Natyrës, Ligjin për Ndryshimet Klimatike, Ligjin për Parqet Kombëtare dhe do të hartojmë Strategjinë për Mbrotjen e Mjedisit. Po ashtu, do të punojmë në përgatitjen e kalendarit për përafimin e legjisacionit me *Acquis* të BE-së dhe do të përgatisim inventarin për emetimin e gazrave serë.

#### **2.12.5 Planifikimi hapësinorë i qëndrueshëm**

Për një planifikim të zhvillimit të qëndrueshëm, do të hartojmë Planin Hapësinor të Kosovës dhe hartën zonale. Për mbrojtjen e parqeve kombëtare, do të hartojmë planet hapësinore për parqet kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" dhe do të ngrisim kapacitetet e Institutit për Planifikim Hapësinor. Ndër të tjera, do të angazhohemi në avancimin e kornizës ligjore përfushën e kadastrit, administrimit të tokës dhe shpronësimit dhe do të bëjmë aerofotografimin e territorit të Kosovës, ridisejnimin e gjeoportalit, përditësimin e të dhënavë hapësinore dhe do të zhvillojmë aplikacionin për menaxhimin e të dhënavë të shpronësimit.

#### **2.12.5 Banimi social dhe banimi i përballueshëm**

Qeveria do t'i kushtojë një rëndësi të veçantë edhe banimit social. Për këtë qëllim, do të hartojmë Ligjin për Banim Social dhe politikat dhe planet në harmoni me vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit në nivel kombëtar dhe vlerësimit të gjendjes së procesit të legalizimit dhe përditësimit të objekteve pa leje. Për këtë, do të finalizojmë Studimi i Fizibilitetit për Programin e Banimit Social në Kosovë. Në këtë kontekst, do të sigurojmë një qasje progresiste. Duke mos lënë askënd prapa, duke mos lënë askënd jashtë, do të sigurojmë të dinjitetshëm, individual e social për të gjithë. Për të moshuarit, që presin ndihmën tonë do t'i ndërtojmë edhe 5 shtëpi të tjera me shërbime të përkujdesjes për ta.

Ndër të tjera, do të mundësojmë banim të përballueshëm për 4 mijë familje. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet programit “120×120” dhe “150×150”, ku familjet përfituese do të bëhen pronarë të banesave me këste mujore prej vetëm 120 respektivisht 150 eurove, për një periudhë kohore prej jo më shumë se 150 muajve. Kostoja vjetore e këtij projekti është rreth 22 milionë euro, por kjo shumë gradualisht i kthehet institucionit, i cili do të themelohet dhe ngarkohet me zbatimin e projektit.

## **2.13 Infrastruktura**

Do të angazhohemi për krijimin e sistemit të integruar për transportin rrugor, hekurudhor dhe ajror, në funksion të zhvillim ekonomik. Për këtë, do të rishikojmë Strategjinë e Transportit Multimodal dhe kornizën ligjore sektoriale. Po ashtu, do të vazhdojmë zbatimin e projekteve rrugore dhe hekurudhore me rëndësi shtetërore dhe do të planifikojmë projekte të reja për ndërlidhje më të mirë të rajoneve të Kosovës dhe shteteve fqinjë. Ndër të tjera, për përmirësimin e sigurisë në komunikacion, mirëmbajtjen e rrugëve dhe përmirësimin e shërbimeve, do të rishikojmë kornizën ligjore si dhe do të instalojmë sistemin inteligent të transportit (ITS).

### **2.13.1 Infrastrukturë rrugore të integruar**

Krijimi i sistemit të integruar për transportin rrugor mundëson lidhje më të mirë dhe më të shpejtë mes rajoneve brenda vendit dhe jashtë saj. Për të arritur këtë, do të përfundojmë projektet ekzistuese infrastrukturore, si ndërtimin e segmentit të autostradës Besi-Merdare dhe autostradës Prishtinë - Gjilan, zgjerimi i rrjetit ekzistues rrugor Prishtinë-Mitrovicë dhe autoudhën Kijev-Zahaq, do të zbatojmë projektet e reja si zgjerimi i rrugëve nacionale Istog- Pejë- Deçan - Gjakovë - Prizren, përfshirë rrugët qarkore, rehabilitimin e rrugëve kombëtare Qafë Duhël - Shtime-Ferizaj, që lidhet me autostradën Prishtinë - Shkup, si dhe ndërtimi i rrugëve kufitare Deçan-Plavë, Prizren-Tetovë dhe Gjilan - Kumanovë.

Po ashtu, vëmendje të veçantë do t'i kushtojmë rehabilitimit të rrjetit ekzistues si dhe ndërtimit të rrugëve të reja, si dhe ndërtimit të unazës së jashtme të Prishtinës.

### **2.13.2 Infrastrukturë hekurudhore për zhvillim ekonomik**

Do të punojmë për modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të qëndrueshme. Për këtë qëllim, vëmendje e veçantë do t'i kushtojmë harmonizimit të kornizës ligjore me *acquis* së BE-së për tregun hekurudhor, në veçanti, harmonizimi i Ligjit për Hekurudhat si dhe projekteve infrastrukturore, si rehabilitimi dhe modernizimi i linjës hekurudhore 10-të (Fushë-Kosovë - Hani i Elezit dhe Fushë-Kosovë - Mitrovicë-Leshak), studimi i fizibilitetit për linjën hekurudhore Kosovë - Shqipëri, Prishtinë-Aeroporti i Prishtinës, si dhe aplikimi për anëtarësim të Kosovës në organizata ndërkombëtare të Transportit hekurudhor (UIC, RNE, ERA, CIM).

### **2.13.3 Politikat e aviacionit civil**

Në kuadër të politikave të aviacionit civil, do të vazhdojmë të mbështesim autoritetet në ndërtimin dhe zhvillimin e hapësirës së ulët ajrore, hapjen e rrjedhës së trafikut në korridore të reja në hapësirën e ulët ajrore dhe në ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe resurseve njerëzore, për pavarësimin në ofrimin e shërbimeve ajrore në hapësirë të lartë të Kosovës, nga Prishtina. Për këtë, vëmendje të veçantë do

t'i kushtojmë integrimit të hapësirës së ulët ajrore në sisteme me fqinjët, me theks të veçantë me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, si ndihmë drejt automatizimit të sistemit për menaxhim të trafikut ajror, kthimit të kontrollit të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, që ndikon në zhvillimin e industrisë së avacionit civil dhe aplikim për anëtarësim të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare të avacionit, duke nisur nga përgatitjet për aplikimin në International Civil Aviation Organization (ICAO), si dhe të rrisim bashkëpunimin me European Organisation for the Safety of Air Navigation (EUROCONTROL), European Civil Aviation Conference (ECAC) dhe të avancojmë partneritetin me agjencinë e Bashkimit Evropian, European Aviation Safety Agency (EASA).

Po ashtu, do të koordinojmë planifikimin tranzitor, duke kyçur dhe integruar Kontrollorët e Trafikut Ajror Kosovar në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës, që ndihmon nevojën për certifikim të operimeve dhe shërbimeve të ofruara. Sa i përket investimeve në infrastrukturë, do të bëjmë mbulimin e kostos së investimeve të infrastrukturës, në pajtim me rregullat, politikat dhe praktikat evropiane.

#### **2.13.4 Siguria dhe mirëmbajtja rrugore**

Do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë nivelit të ulët të sigurisë rrugore, nëpërmjet vendosjes së sistemit intelligent të transportit (ITS), mirëmbajtjes dhe sinjalizimit të rrugëve nationale dhe rajonale të Kosovës, ngritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e inspektimit të sigurisë rrugore dhe funksionalizimit të strukturave për sigurinë e trafikut rrugor. Do të krijojmë qendra mobile për kontrollim të automjeteve në rrugë për kontrollin e emetimit të gazrave të liruar nga automjetet, përmirësimin e sistemit të dhënavë për aksidente rrugore dhe identifikimin e akseve rrugore me rrezikshmëri të lartë.

Po ashtu, do të plotësojmë kornizën ligjore për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologim të mjeteve rrugore, për automjetet dhe patent shofer, për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore, për kushtet e pjesëmarrjes në rrugë të automjeteve, licencimin e operatorëve të transportit rrugor të mallrave, dhe për licencimin e makinistëve.

## **2.14 Energjia dhe minierat**

Vizioni jonë është krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, që synojmë ta arrijmë nëpërmjet teknologjisë dhe energjisë së pastër e të përballueshme.

### **2.14.1 Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji**

Do të angazhohemi për krijimin e kushteve të favorshme për furnizim të qëndrueshëm e të përballueshëm me energji, për të gjithë qytetarët dhe ndërmarrjet e Kosovës, duke e pasur parasysh edhe ndikimin në mjedis. Në këtë aspekt, rol kryesor luan rritja e eficiencës së energjisë dhe rritja e shumëlojshmërisë së burimeve energetike. Duke u bazuar në të dhëna, do të rishikojmë Strategjinë e Enerjisë, me qëllim të harmonizimit me kërkesat energetike në vend, si dhe me përpjekjet për përmirësimin e ambientin në të cilin jetojmë. Po ashtu, do të hartojmë Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë dhe do të rishikojmë kornizën ligjore, që të jetë në harmoni të plotë me strategjinë e re të energjisë.

Ndër të tjera, do të punojmë në përmirësimin e menaxhimit të kapaciteteve ekzistuese energetike, si bazë për siguri në furnizim energetik dhe rrugë e drejtë gjatë tranzicionit e dekarbonizimit energetik. Do të zbatojmë masat ambientale në termocentralin Kosova B dhe do të dekomisionojmë asetet jo-funksionale të Kosovës A. Rëndësi të veçantë do t'i kushtojmë shqyrtimit të fizibilitetit të të gjitha mundësive për zhvillimin e sistemit të gazit natyror, si dhe krijimit të tregut sa më konkurrues energetik. Nëpërmjet Fondit për Eficiencë të Energjisë (EE), i cili do të jetë i qëndrueshëm financiarisht, do të zbatojmë masat e EE, me synim që skemat financiare të shtrihen edhe në mbështetjen e sektorit privat dhe amvisëri.

### **2.14.2 Përmirësimi i performancës së sektorit minerar**

Do të angazhohet për shfrytëzimin optimal të burimeve minerare. Do të avancojmë kornizën ligjore dhe do të analizojmë gjendjen e Trepçës dhe minierave të tjera në Kosovë, me qëllim të ngritjes së performancës së tyre dhe do të identifikojmë potencialin e rritjes së kapaciteteve prodhuese. Të gjitha intervenimet në këtë sektor, do t'i mbështesim në alternativa të arsyeshme ekonomike, teknologjike, sociale e mjedisore.

## **2.15 Arsimi dhe shkenca**

Arsimi është mundësi e madhe dhe burim shumë i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqërор тë Kosovës. Për shfrytëzimin e kësaj mundësie, ne planifikojmë 6 zona të domosdoshme të transformimit: edukimin parashkollor, tekstet e reja shkollore, shkollimin profesional, sistemin e bursave, arsimin e lartë pa pagesë dhe themelimin e fondit për hulumtime shkencore. Jetësimi i projektit për edukimin parashkollor në çdo komunë do të paraprihet nga një hap i rëndësishëm, që është ofrimi i kushteve preferenciale të pagesës ose heqja e pagesës për çerdhen e fëmijëve për kategori të caktuara të popullsisë. Me përmirësimin e cilësisë së teksteve të reja shkollore, do të avancojmë arsimin parauniversitar dhe do të fillojmë planifikimin për shkollat digitale. Shkollat profesionale të mesme të larta do t'i ringjallim e modernizojmë me mjetet, kurrikulat, tekstet dhe materialet mësimore, profilet dhe vecanërisht me programin e praktikës. Shtrirjen dhe rritjen e tyre do ta planifikojmë sipas strategjisë zhvillimore në këmbim me kërkesat e ndërmarrësisë. Do të fuqizojmë e mbështesim me prioritet vajzat, nëpërmjet 1000 bursave studentore, me përparësi ato që zgjedhin të studiojnë shkencat teknike e natyrore. Do të angazhohemi për arsimin e lartë publik pa pagesë dhe do t'i fuqizojmë universitetet drejt kërkimit shkencor.

### **2.15.1 Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i digjitalizuar**

Do të angazhohemi për arsim cilësor nëpërmjet stabilizimit të gjendjes në shkolla pas pandemisë COVID-19. Përveç kësaj, sigurimi i cilësisë në institucionet e arsimit parauniversitar, përmirësimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe punës edukative-arsimore në institacione, janë pjesë e synimeve tona kryesore për këtë nivel të arsimit. Përmirësimi i qasjes dhe përfshirjes në edukimin në fëmijëri të hershme do të arrihet nëpërmjet ndërtimit të çerdheve të reja, ridestinimit të hapësirave shkollore për këtë nivel si dhe ofrimit të kushteve preferenciale të pagesës ose lirimt nga pagesa për familjet në nevojë. Do të ndryshojmë rrënjosht paradigmën në arsimin fillor, duke e shqyrtaar mundësinë e zëvendësimit të notimit diferencial për klasat 1 deri 4 dhe zëvendësimit me vlerësimin formativ. Në arsimin parauniversitar logjika gjuhësore, logjika matematikore dhe mendimi kritik do të janë pjesë e praktikave të mësimdhënies në të gjitha nivelet. Do të ofrojmë në gjithë vendin shujta falas për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën. Parakusht për rritjen e cilësisë në arsim është edhe mbështetja e mësimdhënësve në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve. Do të krijojmë bibliotekat e mësimdhënësve duke i pajisur ato me literaturën relevante dhe të kohës. Do të ofrojmë edhe banimin për mësimdhënësit, me kosto të përballueshme. Në bashkëpunim me mësimdhënësit do të sigurojmë një model të vlerësimit dhe shpërbllimit të performancës.

Do të rrisim besueshmërinë për rezultatet e testeve kombëtare dhe do të hartojmë politika arsimore bazuar në të dhëna. Po ashtu, do të punojmë për gjithëpërfshirje në arsim për fëmijët nga grupet e marginalizuara, nëpërmjet ofrimit të mundësive të barabarta, krijimit të mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkolla. Do të bashkëpunojmë me Ministrinë e Arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe institucionet vartëse të saj. Po ashtu, do të angazhohemi për përmirësimin e infrastrukturës dhe shfrytëzimit efektiv të teknologjive digitale në procesin mësimor.

### **2.15.2 Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës**

Do të angazhohemi për harmonizimin e arsimit dhe aftësimit profesional me tregun e punës, nëpërmjet ndërlidhjes së kurrikulave me tregun e punës. Për këtë qëllim, do t'i avancojmë profilet e shkollave të mesme profesionale me profesione, për të cilat ka kërkesë për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Shkollat profesionale do të pajisen me punëtori për realizimin e punës praktike. Për të arritur këtë, do të funksionalizojmë dhe rrisim së kapacitetet Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve, duke vazduar me finalizimin e kurrikulës bërthamë dhe rishikimin e kurrikulave të AAP, zhvillimin e programeve të nivelit KKK/EQF 5 dhe standardeve të profesionit, si dhe do të zhvillojmë një programi njëvjeçar master për mësimdhënësit e AAP. Do të angazhohemi edhe për krijimin e kushteve për zhvillimin e punës praktike dhe praktikës profesionale (praktika në vendin e punës), si dhe përmirësimin e orientimit dhe këshillimit në karrierë me anë të zhvillimit të një modeli të orientimit dhe këshillimit në karrierë në AAP dhe kryerjen e studimeve gjurmuese.

### **2.15.3 Menaxhim efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet**

Do të angazhohemi për menaxhim efektiv të arsimit nëpërmjet riorganizimit të Ministrisë dhe rishikimit të roleve të agjencive vartëse të saj, avancimit të politikave dhe kornizën ligjore në fushën e arsimit, ndërtimit të një sistemi efektiv për menaxhimin e shkollës, nëpërmjet fuqizimit të kapacitetet menaxheriale të shkollave, rishikimit të metodologjisë dhe formulës se financimit të arsimit parauniversitar dhe vendimmarrjes në arsim që bazohet në të dhëna.

### **2.15.4 Arsim i lartë me cilësi dhe integritetit, në harmoni me standarde ndërkombëtare**

Do të angazhohemi për cilësi dhe integritetin në arsimin e lartë, nëpërmjet zbatimit të procesit të akreditimit në pajtim me standarde ndërkombëtare të cilësisë, që do të mundësojë rikthimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në ENQA dhe EQAR. Po ashtu, do të ruajmë pavarësinë profesionale dhe funksionale të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe do të ofrojmë mbështetjen për kërkesat e tyre për burime njerëzore e

buxhetore. Ndër të tjera, do të angazhohemi për institucionalizimin e kontrollit anti-plagjaturë, rritjen e transparencës në arsimin e lartë, përmirësimin e kushteve për studentët, ndërlidhjen e programeve në arsimin e lartë me tregun e punës dhe organizimin e punës praktike për studentët në institucionet publike dhe private. Do të lehtësojmë procedurat e angazhimit vullnetar të studentëve dhe do të njohim këtë angazhim si përvojë të punës. Ne jemi për arsim publik falas. Në institucionet publike do të hiqen tarifat për pagesën e semestrit. Do të punojmë në sigurimin e qasjes në literaturën bashkëkohore, si dhe në sigurimin e bursave për studentë brenda dhe jashtë vendit.

### **2.15.5 Përmirësimi i mjedisit për kërkime dhe inovacion**

Përmirësimin e mjedisit për kërkime shkencore do ta arrijmë nëpërmjet sigurimit të financimit për veprimtarinë kërkimore-shkencore në pajtimin me ligjin në fuqi, si dhe integrimin e Kosovës në hapësirën kërkimore evropiane duke fituar statusin e asociuar në Horizon Europe. Do të themelojmë Fondin e Hulumtimeve që do t'i dedikohet kërkuesve, ligjëruesve, profesorëve e specialistëve mjekësorë, ku këto hulumtime, të cilat do përdoren si evidencë për politikëbërje. Do të themelojmë Këshillin për Inovacion dhe do të aplikojmë për anëtarësim në European Innovation Scoreboard. Do të prodhojmë statistikat në pajtim me standarde ndërkombëtare për këtë fushë dhe do të ndërlidhim punën hulumtuese në universitete me industrinë, përmes qasjes së specializimeve të mençura. Do të hartojmë Strategjinë për Specializim të Mençur, që do të jetë një nga masat kryesore, si dhe do të funksionalizojmë Parkun e Trajnimeve dhe Inovacionit në Prizren, nëpërmjet të cilave do të sigurohem se talenti, dija dhe puna e rinisë do të optimalizohen. Këto do t'i arrijmë duke i mbështetur bizneset me qëllim të stimulimit të ndërmarrësisë dhe inovacionit.

## **2.16 Kultura, Rinia dhe Sporti**

### **2.16.1 Arti dhe kultura si kontribuues qenësor në mirëqenien shoqërore e ekonomike**

Në fokus të politikës dhe reformës kulturore do të jenë institucionet kombëtare të kulturës dhe skena e pavarur kulturore. Do të angazhohemi për reformimin administrativ të institucioneve kombëtare të kulturës për të siguruar autonominë financiare dhe qëndrueshmërinë institucionale të tyre. Për arritjen e këtij synimi do të rishikojmë kornizën ligjore dhe aktet që rregullojnë organizimin e rendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës. Hapja e llogarive bankare, kodeve buxhetore dhe rekrutimi i zyrtarëve financiarë janë veprime për të fuqizuar autonominë financiare dhe menaxhuese të institucioneve. Kujdes të veçantë do t'i kushtojmë zgjedhjes së profesionistëve të dëshmuan në krye të institucioneve kombëtare të kulturës, bashkë më sigurimin e mbështetjes së qëndrueshme financiare.

Qeveria do të angazhohet për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe ligjore të institucioneve kombëtare të kulturës për konsolidim të kushteve të punës dhe veprimtarisë artistike. Në fazën fillestare do të ndërmerren ndërhyrje emergjente rinnovuese në ndërtesat e Teatrit Kombëtar, Baletit Kombëtar, Bibliotekës Kombëtare dhe Arkivit Shtetëror, ndërsa ndërhyrjet rinnovuese në ndërtesat e institucioneve të tjera do të realizohen sipas nevojës dhe vlerësimit. Në të njëjtën kohë, do të bëjmë konceptimin dhe themelimin e institucioneve të reja kombëtare të kulturës (Teatri i Operas dhe Baletit, Teatri i ri Kombëtar, Muzeu i Artit Bashkëkohor, Rrjeti i kinemave të Kosovës).

Qeveria synon zhvillimin e librit përmes botimit, blerjes, përkthimit dhe nxitjes së lexueshmërisë. Do të mbështesim programe te veçanta të Bibliotekës Kombëtare dhe bibliotekave komunale, ndërsa planifikojmë rritje të mbështetjes për autorët dhe botuesit (botim, blerje dhe përkthim i librave). Me interes të veçantë për qeverinë është zhvillimi dhe zbatimi i programeve për nxitjen e lexueshmrisë. Këshilli i Librit do të ketë rol qendror në përparimin e politikës së librit, derisa bashkëpunimi me Shqipërinë do të jetë ndër prioritetet e kësaj fushe.

Qeveria do të angazhohet për edukimin artistik të të rinjve dhe zhvillimin e kuadrove profesionale në fushën e kulturës. Ndër nismat me interes të veçantë në kuadër të edukimit artistik është zbatimi i programit shkollor për pjesëmarrje të rritur dhe të rregullt të nxënësve në ngjarjet kulturore. Ndërsa përmes rritjes së bashkëpunimit mes institucioneve kombëtare dhe lokale të kulturës synojmë që krijimtarinë artistike ta bëjmë më të qasshme për të rinxjtë anekënd Kosovës. Qeveria do të investojë në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në fusha deficitare, me fokus të veçantë në dokumentim kulturor dhe menaxhim kulturor.

Institucionet dhe krijuesit e skenës së pavarur kulturore do t'i trajtojmë si partnerë strategjikë për zhvillimin e kulturës dhe zhvillimin e vendit. Konkretisht do të angazhohemi për njohje ligjore dhe mbështetje të rritur financiare për fuqizimin e skenës së pavarur kulturore. Në bashkëpunim me pjesëtarët e skenës së pavarur kulturore do të themelojmë Fondin Kulturor si instrument më efikas për rritjen e mbështetjes financiare dhe zhvillimin e skenës së pavarur. Qeveria do të kujdeset për definimin e statusit të artistit (krijuesit). Ndër veprimet konkrete do të jetë edhe zhvillimi i Regjistratit të institucioneve dhe profesionistëve të kulturës (publike dhe të pavarura).

Qeveria do të mbështesë programe dhe nisma që mundësojnë zgjerimin e hapësirave kulturore kryesisht përmes shndërrimit të hapësirave (dhe ndërtesave) të pashfrytëzuara publike në hapësira kulturore që menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme. Gjithashtu, do të punojmë për zhvillimin e diplomacisë kulturore për të promovuar identitetin tonë shtetëror në botë. Konkretisht do të mbështesim promovimin ndërkombëtar të artit dhe kulturës së Kosovës, si dhe do të fuqizojmë qendrat kulturore të Kosovës në diasporë. Qeveria do t'i kushtojë rëndësi të veçantë përmirësimit të praktikave për mbrojtjen e së drejtës së autorit përmes zbatimit të tarifës së ritransmetimit dhe bashkëpunimit me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale.

Bashkëpunimi kulturor me Shqipërinë do të jetë pjesë integrale dhe e natyrshme e punës së qeverisë. Fillimisht do të bëhet dinamizimi i zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese kulturore mes Kosovës dhe Shqipërisë. Krahas rritjes së mobilitetit artistik dhe kulturor mes dy vendeve tona, me qeverinë e Shqipërisë do të punohet aktivisht në prezantimin e përbashkët kulturor në nivel ndërkombëtar. Bashkëpunimi kulturor me Shqipërinë do të fokusohet edhe në financimin e përbashkët të ngjarjeve kulturore, organizimin e përbashkët të ngjarjeve të rëndësishme kulturore dhe rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve simotra kombëtare të kulturës.

**2.16.2 Trashëgimia kulturore për promovim të vlerave dhe rritje ekonomike**  
Qeveria do të angazhohet për rishikimin dhe plotësimin e kornizës ligjore (primare dhe sekondare) për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore në përputhje me Konventat Evropiane dhe Kartat Ndërkombëtare. Paralelisht do të punohet në funksionalizimin e mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit sistematik të gjendjes së monumenteve të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër, do të bëhet vlerësimi i zbatimit të strategjisë ekzistuese për trashëgiminë kulturore, hartimi dhe miratimi i udhëzuesve për menaxhim të aseteve, hartimi dhe miratimi i planeve të menaxhimit dhe krijimi i mekanizmave për monitorim sistematik të monumenteve të trashëgimisë kulturore.

Qeveria do të fuqizojë me resurse dhe staf Inspektoriatin e trashëgimisë kulturore për të siguruar mbikëqyrje efektive dhe parandalim me kohë të të gjitha aktivitetave që

cenojnë asetet e trashëgimisë kulturore. Do të nisim procesin e licencimit të entiteteve profesionale (kompani dhe individë) për restaurime për të pamundësuar kryerjen e punëve restauruese nga kompani joprofesionale. Krahas fuqizimit të sistemit shtetëror për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë, qeveria do të angazhohet për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore.

Kujdes të veçantë do t'i kushtojmë rregullimit të statusit të mbrojtjes së përhershme ligjore për të gjitha kategoritë e trashëgimisë kulturore. Kjo do të arrihet përmes zhvillimit të mekanizmave (formularëve përkatës) për mbrojtje të përhershme, përgatitjes dhe zbatimit të procesit të propozimit të aseteve për mbrojtje të përhershme (proces i zhvilluar në katër fazë) dhe hartimit e publikimit të Inventarit të Trashëgimisë Kulturore të Kosovës (për të gjitha kategoritë ligjore). Krahas mbrojtjes ligjore, qeveria do të angazhohet në përmirësimin e gjendjes fizike të monumenteve të trashëgimisë kulturore në rrezik dhe funksionalizimin e tyre. Hartimi i programit për Masat Emergjente / Masat Preventive dhe themelimi i fondit për ndërhyrje emergjente janë veprime të fazës fillestare. Gjithashtu do të përcaktohet lista prioritare e ndërhyrjeve restauruese në asetet e trashëgimisë kulturore, për të vazduar me projekte restaurimi dhe revitalizimi të aseteve përkatëse (sipas listës prioritare). Monumentet e restaruara do të revitalizohen përmes metodës së ripërdorimit përshtatës (adaptive reuse) duke e integruar kriterin e qëndrueshmërisë financiare në menaxhimin e aseteve të trashëgimisë kulturore. Qeveria do të angazhohet me përkushtim për mbrojtë efektive dhe zhvillim të qëndrueshëm të të gjitha aseteve të trashëgimisë kulturore, me theks të veçantë të komuniteteve jo-shumicë.

Qeveria do të hartojë edhe planet e hollësishme rregulluese për qendrat historike dhe zonat e veçanta të mbrojtura, për të vazduar me ndërhyrje restauruese dhe revitalizuese në qendrat historike të Kosovës. Qeveria do të trajtojë me prioritet planifikimin e integruar të zonave të veçanta të mbrojtura dhe zonave të tjera me interes të veçantë në nivelin qendror dhe lokal. Do të fillojmë me vlerësimin e Dokumentit Strategjik për Konservim të Integruar (2011). Me përkushtim të veçantë do të trajtohet përcaktimi i zonave mbrojtëse të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe përfshirja e tyre në dokumente të planifikimit hapësinor (Hartën Zonale të Kosovës). Qeveria do të themelojë njësinë e veçantë ndër-institucionale për planifikim dhe menaxhim të integruar.

Promovimi i trashëgimisë shpirtërore do të shërbejë si mjet për ngritje të vetëdijes dhe edukim të gjeneratave të reja. Do të krijohet inventari shtetëror i trashëgimisë shpirtërore, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, do të angazhohemi për zhvillimin e kapaciteteve të muzeve të Kosovës, bashkë me themelin e muzeve të reja. Si hap fillestare do të krijojmë inventarin shtetëror të objekteve të luajtshme të cilat gjenden në muzetë ekzistuese të Kosovës, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Do të zhvillojmë një studim fizibiliteti në sektorin e

muzeve ekzistues në Kosovë (nivel kombëtar, rajonal dhe lokal) për të kaluar në fazën e zhvillimit të projekteve të reja muzeale kombëtare dhe komunale. Synojmë dinamizimin e punëve përfundimin e Muzeut të ish-burgut të Prishtinës dhe Muzeut të Historisë së Natyrës.

Qeveria do të angazhohet për ngritjen e kapaciteteve profesionale për rritjen e efikasitetit të shërbyesve civil në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mbështetjen financiare të institucioneve të trashëgimisë kulturore. Me institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore do të punohet në rishikimin e skemës organizative, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e mbështetjes financiare. Gjithashtu, do të zhvillojmë dhe zbatojmë programeve të edukimit formal dhe jo-formal rrëth trashëgimisë dhe diversitetit kulturor. Do të angazhohemi për përfshirjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në plan program të shkollave fillore dhe të mesme dhe përdorimin e metodave të ndryshme kreative të edukimit joformal mbi trashëgiminë kulturore. Do të organizojmë kampe të restaurimit për lokalitetet e trashëgimisë kulturore duke i targetuar të rinjtë, mjeshtrit dhe pronarët.

### **2.16.3 Sporti zhvillues i imazhit shtetëror dhe mirëqenies shoqërore**

Qeveria synon të konsolidojë politikat kombëtare të sportit për t'i harmonizuar ato me standardet e organizatave ndërreveritare dhe botërore të sportit. Në këtë kuadër, do të bëhet hartimi i strategjisë kombëtare të sportit, zhvillimi i politikave të diplomacisë sportive, rishikimi i ligjeve dhe akteve nënligjore të sportit dhe funksionalizimi i mekanizmave për monitorimin sistematik të të dhënave në fushën e sportit. Me përkushtim do të angazhohemi për luftimin e keqpërdorimit/manipulimit në sistemin sportiv, duke e mbrojtur integritetin e sportit përmes zbatimit të parimeve të qeverisjes së mirë. Hartimi dhe miratimi i kodit të qeverisjes së mirë sportive, krijimi i mekanizmave për monitorimin e qeverisjes së organizatave sportive, përkrahja e programeve dhe projekteve për promovimin e parimeve të qeverisjes së mirë në sistemin sportiv janë veprime të domosdoshme. Gjithashtu, do të zhvillojmë mekanizmat e nevojshëm për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e veprimtarisë sportive, përsht themelimin e Agjencisë Anti-Doping të Kosovës dhe fuqizimin e programeve dhe projekteve me fokus në promovimin e vlerave sportive dhe mbrojtjen e integritetit sportiv.

Qeveria do të angazhohet në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe kuadrove me njohuri profesionale për menaxhimin dhe administrimin sportiv. Ne synojmë fuqizimin e programeve dhe trajnimeve vendore për zhvillimin e kapaciteteve të administratorëve sportiv. Në veçanti do të zhvillojmë kapacitetet profesionale të mjekëve sportiv, ndërsa do të nisim ndërtimin e platformave mbështetëse për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në laboratorët e mjekësisë sportive.

Me prioritet do të trajtohet fuqizimi i edukimit fizik si pjesë integrale e sistemit arsimor përmes sportit shkollor dhe sportit universitar. Do të bëhet përforcimi i rolit dhe ngritja e cilësisë së edukimit fizik në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në Kosovë. Në këtë kuadër, qeveria do të bëj plotësimin përbajtësor të literaturës së edukimit fizik, hartimin e materialeve informuese/edukuese për përgatitjen e mësimdhënësve dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve dhe akterëve tjerë të përfshirë në edukimin fizik formal dhe jo-formal. Gjithashtu, do të themelohet edhe Instituti për kërkime shkencore në fushën e sportit.

Do të angazhohemi për përfshirjen aktive të komunitetit në aktivitete sportive rekreacionale dhe shëndetësore. Qeveria do të mbështesë programe dhe projekte që promovojnë dhe nxisin aktivitetin fizik në komunitet, integrimin shoqëror të grupeve të nënpërfaqësuara, aktivitetin fizik të personave me aftësi të kufizuar, masivizimin e sportit për vajzat dhe gratë. Në fokus të mbështetjes qeveritare do të jenë edhe programet e promovimit të benefiteve të aktivitetit fizik në mirëqenien tonë fizike, sociale, emocionale, dhe mentale, si dhe të promovimit dhe rritjes së vullnetarizimit në sport.

Qeveria do të trajtojë me prioritet zhvillimin e sportit elitar dhe rritjen e rezultateve kulminante sportive në arenën ndërkombëtare. Ndër synimet me ndikim afatgjatë është zhvillimi dhe zbatimi i programit për identifikimin dhe zhvillimin sistematik të talenteve sportiv. Do të rishikojmë ekzistueset dhe hartojmë programe të reja për përkrahjen e vazhdueshme të sportistëve elitarë gjatë karrierës. Qeveria do të kujdeset të përkrahë sportistët gjatë karrierës së tyre sportive (bursat për sportistë) dhe do të zhvillojë platforma mbështetëse për sportistët pas karrierës së tyre garuese.

Krahas rritjes së mbështetjes për organizatat sportive për zhvillimin e veprimtarive të tyre, qeveria do të hartojë kriteret për prioritizim të përkrahjes së aktiviteteve dhe projekteve të organizatave sportive. Me prioritet do të jetë edhe mbështetja e organizimit të garave ndërkombëtare të sporëve me suksese në arenën ndërkombëtare. Do të hartojmë dhe mbështesim programe për zhvillimin e vazhdueshëm të trajnerëve në sport.

Qeveria do të angazhohet për zhvillimin e kapaciteteve infrastrukturore sportive publike në përputhshmëri me standartet ndërkombëtare. Në fazën e parë do të fokusohemi në vlerësimin dhe përmirësimin e gjendjes fizike të infrastrukturës ekzistuese sportive dhe finalizimin e projekteve kapitale sportive që janë në proces të ndërtimit. Do të vazhdojmë me iniciimin e projekteve të reja infrastrukturore, sidomos për sportet që kanë mungesë të hapësirave stërvitore dhe garuese, duke u siguruar përfuqizimin e mekanizmave për monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes fizike të infrastrukturës sportive. Qeveria synon adaptimin e infrastrukturës sportive për personat me aftësi të kufizuar në aktivitet sportiv. Gjithashtu, do të angazhohemi për

planifikimin e administrimit dhe mirëmbajtjes së qëndrueshme të infrastrukturës sportive dhe mbështetjen e nismave për sigurimin e sistemeve dhe pajisjeve teknologjike sportive.

Rregullimi i shfrytëzimit fleksibil të hapësirave ekzistuese sportive në shkolla do t'i ofrojë qasje të lehtë komunitetit për ushtrim të aktivitetit fizik. Me interes është edhe promovimi i projekteve për vetëdijesimin e shfrytëzuesve për ruajtjen e hapësirave sportive. Qeveria do të angazhohet edhe për promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit të industrisë sportive, duke e nxitur bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat dhe sektorit publik në fushën e sportit.

#### **2.16.4 Fuqizimi i të gjithë të rinxve në jetën ekonomike dhe sociale të vendit**

Qeveria synon rritjen e përfshirjes së të rinxve në tregun e punës përmes edukimit jo-formal, politikave aktive, ofrimit të shërbimeve të punësimit, dhe lehtësimit të qasjes në financim për ndërmarrësi. Në këtë kuadër, qeveria do të angazhohet për Themelimin e Fondit për Ndërmarrësit e Rinj, subvencionimin e pagave për të rinxjtë, ndërtimin e laboratorëve ndërmarrës për Teknologji, Inovacion, Art (TIA Lab), përkrahjen direkte financiare për ndërmarrjet e të rinxve dhe fuqizimin e bashkëpunimit me sektorin e biznesit sidomos në sferën e edukimit jo-formal në qendra rimore. Qeveria do të promovojë punën vullnetare në aktivitete të dobishme për shoqërinë duke siguruar stimuj të ndryshëm për ofruesit dhe përdoruesit e vullnetarizmit. Për arritjen e këtij synimi parashihet themeli i Korpusit të Diasporës së Kosovës, promovimi i vullnetarizmit te të rinxjtë, përfshirja e vullnetarizmit në aktivitetet mësimore dhe mundësimi i punës vullnetare jashtë Kosovës.

Qeveria do të krijojë mundësi për fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet të rinxve në Kosovë dhe atyre në diasporë duke mbështetur nisma të përbashkëta kulturore, sportive dhe ndërmarrëse. Në këtë kuadër, do të organizohen aktivitetet e mes të rinxve në Kosovë dhe të rinxve të diasporës, skema subvencionimi për rininë në diasporë që sjellin ideja të reja dhe inovacion, takime ndërmjet të rinxve të kthyer nga emigracioni dhe studimet jashtë vendit, me të rinxjtë që punojnë dhe studiojnë në Kosovë, si dhe kampe verore për trashëgiminë kulturore dhe kulturën e Kosovës për të rinxjtë e diasporës.

Do të mbështesim programe rimore në grupe të nënpërfaqësuara me fokus vajzat, komunitetet minoritare dhe personat me aftësi të kufizuar. Qeveria do të angazhohet për nxitjen e vetëpunësimit të vajzave/grave të reja nga zonat rurale, ndërtimin e Qendrës së Rehabilitimit për të rinxj, promovimin e vullnetarizmit te grupet e nënpërfaqësuara dhe mbështetjen përmes programeve verore dhe edukimit jo-formal për grupet e nënpërfaqësuara. Ndërsa, rritja e përfshirjes aktive të të rinxve në vendimmarrje publike në nivelin qendror dhe lokal do të arrihet përmes fuqizimit të këshillave të veprimit rinxj, funksionalizimit të Këshillit Qendror, organizimit të

Dialogut Rinor Kombëtar (National Youth Conversation), mbështetjes financiare për mekanizmat rinor dhe organizatat dhe promovimit të së drejtës për pjesëmarrje në vendimmarrje.

Qeveria do të angazhohet për ngritjen e vetëdijes dhe qasjen në informacion për të drejtat, liritë dhe mundësitet e të rinjve në Kosovë dhe diasporë. Do të zhvillojmë dhe lansojmë portalin shtetëror për rininë, ndërsa paralelisht do të bëjmë monitorimin sistematik të nevojave të të rinjve. Gjithashtu planifikojmë realizmin e programit për Youth Media që synon fuqizimin e kapaciteteve të medias për çështjet e lidhura me rininë. Qeveria do të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale të organizatave dhe qendrave rinore dhe themelimin e qendrave të reja. Në këtë kuadër, parashihen renovimi dhe ndërtimi i qendrave rinore, trajnimi i udhëheqësve të organizatave rinore dhe shfrytëzimi i objekteve shkolllore në zona rurale për aktivitetet e të rinjve.

Qeveria do të mbështesë aktivitete të shkëmbimit ndërkombëtar përmes anëtarësimit në programet e organizatave botërore dhe financimit të drejtpërdrejtë. Me interes të veçantë për qeverinë janë anëtarësimi në forume dhe organizata ndërkombëtare dhe zbatimi i programeve të shkëmbimit arsimor dhe kulturor.

Synojmë plotësimin e kornizës ligjore për sektorin rinor në harmoni me politikat e Bashkimit Evropian, dhe zbatimin e plotë të tij nga institucionet përgjegjëse. Do të hartojmë koncept-dokumentin për sektorin e rinasë dhe do të fuqizojmë zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Ligji për Rininë në nivelin qendror dhe lokal. Gjithashtu do të angazhohemi për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Rininë përmes koordinimit të mirëfilltë ndërinstitucional. Në fazën e parë do të bëjmë vlerësimin e Strategjisë për Rininë 2019-2023, për të parë ndikimin e deritanishëm dhe sfidat në zbatimin e tij. Do të vijojmë me hartimin e dokumentit të strategjisë së re, ndërsa me prioritet të veçantë do të trajtojmë bashkërendimin e veprimeve mes ministrive që zbatojnë politika dhe programe rinore në Kosovë.

## **2.17 Politika e jashtme dhe diaspora**

Politika e jashtme ka efekt në jetën e përditshme të qytetarëve në mënyra të ndryshme. Për këtë qëllim prioriteti kryesor i Qeverisë është forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, përmes integrimit e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, përmirësimit të shërbimit të jashtëm, strategjisë së lobimit dhe promovimit diplomatik, kulturor dhe ekonomik.

### **2.17.1 Shtet ligjor demokratik me synim integrimin në BE dhe NATO**

Me fillimin e punës së qeverisë së re të Republikës së Kosovës, shteti ynë i ri, si shtet ligjor demokratik dhe evropian, është shndërruar në një prej shtyllave më të rëndësishme stabile dhe demokratike të rajonit tonë.

Me një orientim konstant kah shteti ligjor modern evropian, duke u mbështetur fort në fundamentin tonë politik në bashkësinë e demokracie liberale, në bashkëpunim të ngushtë me ShBA-të, dhe me një pozicionim të qartë kundër tendencave dhe shteteve autoritare, Kosova qëndron fort si një partner dhe i qëndrueshëm e strategjik në krah të miqve dhe aleatëve në BE, NATO dhe më gjerë.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të japë me shumë energji dhe vendosmëri kontributin e saj brenda bashkësisë transatlantike të demokracieve dhe shteteve ligjore. Do të paraqesim kërkesën për anëtarësim të Kosovës në BE dhe NATO si dhe do të anëtarësohemë në Kartën e Adriatikut.

### **2.17.2 Thellimi i bashkëpunimit me vendet me interes strategjik dhe marrëdhënieve dypalëshe**

Republika e Kosovës do ta forcojë subjektivitetin e saj ndërkombëtar. Kjo vlen si për përpjekjet për njohje dhe marrëdhënie të ndërsjellta diplomatike, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, bashkëpunimin ekonomik, shkëmbime kulturore, ashtu edhe për të gjithë spektrin e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral.

Partneriteti me vendet me interes strategjik përvèç pozicionimit të përbashkët liberal ekonomik do të përbajë edhe dimensionin gjeopolitik të kultivimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe avancimin e interesave reciproke. Prioritet i politikës sonë të jashtme do të jetë zgjerimi i partneritetit me SH.B.A-të në aspekte të ndryshme, krahas partneritetit politik do të thellohet bashkëpunimi në rrafshin e sigurisë, zhvillimit ekonomik, arsimit dhe diplomacisë publike. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet vendosjes së marrëdhënieve me shtete jo-njohëse.

Rëndësi të posaçme për Republikën e Kosovës paraqet anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe kultivimi i fqinjësisë së mirë. Qeveria do të angazhohet për zgjerimin e gamës së organizatave në të cilat është anëtare, avancim në statusin e anëtarit të barabartë brenda organizatave dhe avancimin e interesave shtetërore në

kuadër të kornizës institucionale të organizatave, si dhe forcimin e rolit si kontribuues për paqen, sigurinë dhe zhvillimin ndërkombëtar. Thellimi i bashkëpunimit me NATO do të arrihet nëpërmjet intensifikimit të dialogut me NATO-n dhe përfshirjes në Partneritet për Paqe e në Kartën e Adriatikut.

### **2.17.3 Me pavarësi dhe profil të qartë në bashkëpunimin rajonal**

Qeveria e Republikës së Kosovës do të përfaqësojë me profil të qartë dhe të pavarur interesat nationale të vendit dhe qytetarëve të tij në formatet e ndryshme të bashkëpunimit rajonal. Kontributi ynë do të jetë konstruktiv dhe do të synojmë njëkohësisht respektimin e normave ndërkombëtare.

Republika e Kosovës e dëshiron bashkëpunimin rajonal. Mirëpo nevojitet një bashkëpunim pa diskriminim. Kjo vlen që nga njohja e dokumenteve tona shtetërore e deri te përfaqësimi i vendit tonë. Ashtu si Kosova është njohur nga shumica dërrmuese e shteteve anëtare të BE-së dhe NATO-s, po ashtu presim edhe respektimin e plotë të sovranitetit tonë nga shtetet e rajonit.

### **2.17.4 Thellimi i bashkëpunimit me Shqipërinë**

Ky bashkëpunim do të shprehet në mekanizma të përbashkët për interesin kombëtar dhe të mirën e përbashkët. Qeveria e Kosovës do të angazhohet për një qasje të strukturuar dhe të institucionalizuar të bashkëpunimit dhe integrimit ndërsqiptar. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë do të thellohen marrëdhëniet në fusha të ndryshme për të jetësuar marrëveshjet e arritura më parë, si: tregtia, financat, arsimi dhe shkenca, siguria, si dhe në veçanti harmonizimin e politikës së jashtme.

### **2.17.5 Rritja e rolit të mërgatës në zhvillimin dhe promovimin e vendit**

Përfshirja e mërgatës dhe diasporës në proceset politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore të Kosovës është një prej prioriteteve të rëndësishme të Qeverisë. Rëndësi të posaçme do t'i kushtohet rrjetëzimit të profesionistëve në mërgatë, ndërtimit të mekanizmave për transferimin e njohurive, ekspertizës, burimeve dhe krijimin e mekanizmave përfshirje aktive në politikat zhvillimore. Qeveria do të angazhohet në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të diasporës duke fuqizuar zhvillimin e mësimit plotësues në diasporë dhe në lehtësimin e shërbimeve konsullore në misionet diplomatike, si edhe krijimin e mundësive për votim nëpër misione diplomatike. Ligji për diasporën do të ndryshohet për të reflektuar ndryshimet institucionale.

Qeveria gjithashtu do të angazhohet në përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit duke angazhuar mërgatën në diplomaci kulturore, ekonomike dixhitale në mënyrë që të punojmë në promovimin e Kosovës. Në këtë drejtim, do të ndërtojmë një strategji partneriteti

ku vlerësojmë mërgatën si një faktor që do të ushtrojë ndikimin e saj në vendlindje dhe anasjelltas përmes përfshirjes dhe angazhimit të mërgatës në përpilimin e politikave zhvillimore dhe strategjike, angazhim direkt në sektorë të rëndësishëm në implementimin e politikave, prioritet në investime dhe bashkininvestime me biznese vendore. Në mënyrë që të koordinojë përpjekjet me diasporën, sektorin privat dhe partnerët e sektorit të tretë, qeveria do të ndërtojë një dialog të dyanshëm që të përfshijë zërat e të gjithë palëve të interesuara, e i cili duhet shtrirë në të gjitha sferat.

Politika e jashtme ekonomike do të jetë një prej shtyllave kryesore të politikës sonë të jashtme. Politika e jashtme ekonomike e Kosovës nuk do të karakterizohet nga burokracia, por nga baza e shëndoshë ligjore, shërbimi i shpejtë administrativ dhe mbikëqyrja strikte e respektimit të ligjit, e të drejtave të bizneseve dhe të punësuarve. Për arritjen e këtij synimi po hartohet një strategji, e cila nuk synon efektet afatshkura por suksesin afatgjatë dhe në radhë të parë krijimin e vendeve të reja të punës.

Do t'iu drejtohem i sidomos atyre shteteve, në të cilat jeton mërgata dhe diaspora jonë. Nëse partnerët tanë fillojnë të krijojnë një përvojë pozitive me investimet e tyre në Kosovë, me mërgatën tonë, pra ata qindra mijëra ambasadorë, punëtorë të zellshëm dhe profesionistë të ndershëm, nga më të mirët për vendin tonë, me mikpritjen tonë dhe pa korruption, atëherë do të jetë e mundur që edhe Kosova të përjetojë një mrekulli të vogël ekonomike. Në këtë drejtim tashmë është filluar puna intensive.

Ne do t'i japim fund dukurisë së deritanishme të injorimit dhe manipulimit të votës së mërgatës. Do të krijohen mundësi praktike për të lehtësuar votimin duke e mundësuar atë në konsullata dhe ambasada, konform asaj se çfarë nënkuftojmë kur flasim për demokraci, të drejta të barabarta për të gjithë dhe duke u bazuar edhe në praktikat e vendeve të tjera evropiane. Kohët e bllokadës ose keqpërdorimit të mërgatës dhe diasporës nga ana e institucioneve shtetërore do t'i takojnë përfundimisht të kaluarës.

## 2.17.6 Reformimi i shërbimit të jashtëm

Për Politikën e Jashtme është e rëndësishme të bëhet një rikapitulum dhe analizë e sfidave, sukseseve dhe gjendjes aktuale si dhe rishikim funksional të shërbimit të jashtëm si tërsi. Prandaj, shërbimi i jashtëm i Kosovës do të transformohet gradualisht në mënyrë që të jetë efektiv, duke filluar nga përmirësimi i bazës ligjore, ndërtimi i një akademie të mirëfilltë diplomatike, vënia e diplomacisë ekonomike e kulturore si prioritetë të punës së ambasadave të Republikës së Kosovës e deri te përzgjedhja e diplomatëve në bazë të kritereve të matshme të profesionalizmit dhe integritetit. Reforma e shërbimit të jashtëm të Kosovës do të sigurojë shërbim më të mirë për qytetarët jashtë vendit, transparencë, reputacion më të lartë të diplomacisë

si dhe përfaqësim më të dinjitetshëm të Republikës së Kosovës në arenën ndërkontaktuale.

### **2.17.7 Avancimi i diplomacisë ekonomike dhe diplomacisë publike**

Politika e jashtme synon identifikimin gjithnjë e më të fortë të Kosovës me kulturën e saj, si dhe promovimin e mundësive të bashkëpunimit ekonomik të Republikës së Kosovës me investitor të huaj. Diplomacia publike përfshin aktivitete të ndryshme, përbërja e cilave mund të ndryshojë në varësi të specifikave të shtetit me të cilin synohet që të ketë zgjerim të marrëdhënieve ekonomike dhe kulturore. Përcaktimi i orientimeve për diplomaci ekonomike dhe avancimi i diplomacisë publike do të përdoren në mënyrë që arti, kultura dhe sporti mund të përdoren si një instrument i diplomacisë kulturore dhe sportive të ndërtimit të mirëbesimit. Krijimi i lidhjeve ndërmjet vendeve në forma të ndryshme ekonomike do të arrihet nëpërmjet intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe dhe komisioneve të përbashkëta bilaterale ekonomike me qëllim të promovimit dhe lehtësimit të eksportit të produkteve të Republikës së Kosovës në tregun e jashtëm.

### **2.17.8 Liberalizimi i vizave**

Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara për liberalizimin e vizave. Shumica dërrmuese e shteteve anëtare të BE-së, Komisioni i BE-së dhe Parlamenti Evropian e mbështesin dëshirën e qytetarëve të Kosovës për të mos mbetur vendi i vetëm i izoluar në Ballkan. Janë disa nga qeveritë e shteteve anëtare të BE-së, të cilat ende hezitojnë.

Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do të bëjë gabimet e së kaluarës duke dhënë data të gabuara. Me ndihmën e partnerëve tanë ndërkontaktuarë do të punojmë me qeveritë e shteteve që ende janë skeptike që të arrijmë liberalizimin e vizave për qytetarët tanë sa më parë që të jetë e mundur. Nga këto shtete do të kërkojmë njëkohësisht që qytetarët e Republikës sonë mos të bëhen peng i debateve të politikës së brendshme të tyre. Në pyetje është jo vetëm liria e lëvizjes e qytetarëve të Kosovës, por edhe kredibiliteti i institucioneve të BE-së. Nevojitet besim, jo diskriminim.

### **2.17.9 Raporti me Serbinë**

Qeveria e Republikës së Kosovës është e gatshme ta njohë ndërkontaktarisht Republikën e Serbisë nëse kjo e fundit e njeh Republikën e Kosovës dhe në veprimet dhe deklarimet e saj distancohet nga kërcënimi i Republikës së Kosovës dhe i fqinjëve të tjerë në rajon me ndërhyrje politike dhe retorikë nacionaliste e shpesh edhe raciste.

Me partnerët e saj amerikan dhe evropian, Republika e Kosovës do të bëjë të gjitha përpjekjet për të arritur njohjen e ndërsjelltë mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, të mirëmbajë raporte normale të bazuara në parimin e shëndoshë të reciprocitetit, dhe të jep një kontribut të rëndësishëm për paqen, sigurinë dhe stabilizimin afatgjatë të rajonit.

Qeveria e Kosovës angazhohet në dialogun me Serbinë me synim normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve dypalëshe. Dialogu me Serbinë zhvillohet për adresimin e çështjeve ndërshtetërore dhe fqinjësisë së mirë, dhe ka orientim kryesor përfitimet e qytetarëve nga rezultatet e dialogut ndërshtetëror. Marrëveshja finale e synuar do të ketë brenda të gjitha çështjet e pazgjidhura që nga suksesioni i ish Federatës Jugosllave në të cilën Kosova ishte element konstituiv.

Marrëveshjet e deritanishme do të trajtohen për të parë shkallën e përbushjes dhe ndikimin e tyre. Me opozitën do të bashkëbisedojmë rregullisht për të ndërtuar konsensus nacional në përgjithësi sa i përket politikës së jashtme, e në veçanti për raportin me Serbinë.

Qeveria e Kosovës do të marr pjesë në dialogun me Serbinë me parime të qarta dhe me qëllimin që marrëveshja finale përveç çështjeve ndërshtetërore do të përfshijë edhe njohjen reciproke mes shteteve, njohjen nga pesë vendet e mbeturë të BE-së si dhe anëtarësimin në OKB. Përveç rolit ndërmjetësues të Bashkimit Evropian, qeveria e Kosovës e sheh si shumë të rëndësishëm edhe koordinimin e ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qeveria e Kosovës konsideron se pjesëmarrja në dialog duhet të bëhet duke u bazuar në përgatitje të mirëfilltë dhe dakordim të përbashkët për temat që duhet të bisedohen. Për këtë proces do të bashkëpunojmë me partnerët ndërkombëtar dhe do të ftojmë të gjitha partitë politike, si dhe do të angazhojmë ekspertë të njohur për të kontribuar në këtë drejtim.

\* \* \*

Politika e jashtme e një vendi është e mençur kur është e qëndrueshme në parime por fleksibile në realizimin e synimeve.

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës synon forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës dhe përritjen e këtij synimi do të jetë e pavarur, serioze, e parashikueshme dhe e guximshme, si dhe bashkëpunuese me aleatët e miqtë tanë – ShBA-të dhe vendet e BE-së. Me orientimin e saj të qartë politik përvendosjen e shtetit ligjor, qeveria e Republikës së Kosovës do të hapë dyer të reja. Ky orientim dhe besimi masiv qytetar kanë krijuar simpati dhe mbështetje të gjerë te partnerët dhe miqtë ndërkombëtarë të Kosovës, si bazë e re mbi të cilën politika e jashtme e Kosovës do t'i arrijë synimet e saj konkrete.



## **2.18 Politikat e mbrojtjes**

Vizioni jonë është të kemi një forcë të gatshme për mbrojtjen e vendit dhe për të kontribuar në paqen dhe sigurinë globale. Këtë synojmë ta arrijmë nëpërmjet zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve të mbrojtjes me anë të edukimit, stërvitjes dhe modernizimit të forcës, sipas standardeve të NATO-së.

### **2.18.1 Zhvillimi i kapaciteteve për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial**

Për zhvillimin e kapaciteteve të Forcës, do të krijojmë njësitë me prioritet të fazës së dytë dhe do të modernizojmë e standardizojmë mbrojtjen, duke u bazuar në Tabelën e Organizimit të Personelit dhe Pajisjeve dhe Programet e Mbrotjtes. Ndër të tjera, do të mbajmë dhe avancojmë gatishmërinë operacionale, sipas Kapaciteteve Fillestare Operacionale dhe Kapaciteteve të Plota Operacionale. Po ashtu, do të angazhohemi në blerjet ushtarake, respektivisht me pajisjet ushtarake dhe ndërtimin e infrastrukturës fizike, sipas standardeve të NATO-së.

### **2.18.2 Mbajtja e kapaciteteve ekzistuese për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile**

Do të ngrisim kapacitetet profesionale për mbështetje ushtarake të autoriteteve civile nëpërmjet programeve të mirëmbajtjes, edukimit, trajnimeve dhe stërvitjeve. Për këtë qëllim, do të zhvillojmë planet për operacione të deminimit, inspektim të materieve të rrezikshme, operacione xheniere, operacione për kërkim shpëtim dhe operacione për bashkërendim ndër institucional.

### **2.18.3 Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile dhe rritja e llogaridhënieve dhe transparencës**

Do të kompletojmë kornizën ligjore dhe strategjike në fushën e mbrojtjes, ku mes tjerash, do të hartojmë kornizën ligjore për agjencinë e inteligjencës ushtarake, policinë ushtarake, deminim humanitar dhe për dërgimin e FSK-së jashtë vendit. Do të zhvillojmë udhëzues për shpërndarje të bursave të Ministrisë, për krijimin e specialitetave profesionale ushtarake dhe për avancimin e karrierës së stafit civil në Ministri dhe FSK. Po ashtu, do të hartohet planin afatgjatë zhvillimor, rishikojë planin afatmesëm dhe rishikimin e strategjisë për siguri kibernetike të Ministrisë.

### **2.18.4 Anëtarësimi në organizata, bashkëpunimi me vendet tjera dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare**

Do të angazhohemi në vazhdimësi për zgjerimin e hartës së bashkëpunimit dypalësh dhe për rritjen e partneritetit me shtetet tjera në operacionet ndërkombëtare, nën mbikëqyrjen e NATO-së. Po ashtu, do të angazhohemi për diplomaci ushtarake në funksion të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, me fokus të veçantë në anëtarësimin në Kartën e Adriatikut. Ndër të tjera, do të avancojmë bashkëpunimin

me shtetet tjera, për arritjen e qasjes ndër-shtetërore dhe ndërkombëtare, për pajisjet ushtarake dhe blerjet nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes.

### **3. Prioritizimi, dhe monitorimi i zbatimit të Programit të Qeverisë**

Do ta monitorojmë gjendjen ekonomike dhe zbatimin e prioriteteve të përcaktuara në këtë Program katër-vjeçar të qeverisjes, si dhe do të reagojmë varësisht nga situata ekonomike. Këto prioritete do të zbatohen brenda kufijve buxhetor. Prandaj, Programin do ta rishikojmë çdo fillim vit finanziar, nëpërmjet Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, me qëllim të përditësimit me sfidat dhe mundësitet e reja, brenda koordinatave të politikave qeverisëse.

Prioritizimi i Programit do të bëhet nëpërmjet Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, duke vlerësuar nevojën për intervenime në fusha prioritare dhe varësisht nga zhvillimet me situatën e pandemisë.

Operacionalizimi i mëtejshmë i prioriteteve të Qeverisë do të bëhet fillimisht duke rishikuar buxhetin këtë vit, si nevojë e reflektimit të strukturës institucionale. Korniza e monitorimit dhe raportimit do të mundësoj matje të performancës dhe prezantim të rezultateve të Qeverisë para publikut.

## **Shtojca 1: Programi legjislativ për vitin 2021**